



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.2.2024, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për dhënie amnistie”.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Jurgis Çyrbja, Toni Gogu, Damian Gjiknuri, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Eduard Ndreca, Olta Xhaçka, Denis Deliu, Arkend Balla, Gledis Çeliku, Ermonela Felaj, Gerta Duraku, Dhurata Çupi, Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Klevis Xhoxhi, Enkelejd Alibeaj, Plarent Ndreca, Saimir Korreshi dhe Petro Koçi.

#### **Mungojnë:**

Bledion Nallbati, Gazment Bardhi, Elda Hoti, Greta Bardeli, Oerd Bylykbashi, Erisa Xhixho, Fatmir Mediu, Dashnor Sula dhe Xhemal Qefalia.

#### **Të ftuar:**

Ulsi Manja - ministër i Drejtësisë

Elsonida Rama – drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit

#### **HAPET MBLEDHJA**

**Klotilda Bushka** – Mirëdita, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me rendin e ditës sipas njoftimit. Sot kemi vijimin e diskutimit të projektligjit “Për dhënie amnistie”, nismë e Këshillit të Ministrave, ku relator është kolegu Plarent Ndreca. Ndërkohë, nga Ministria e Drejtësisë kemi prezentë ministrin, zotin Ulsi Manja, dhe zonjën Elsonida Rama, drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Në lidhje me këtë projektligj, ju informoj se sot, në vijim të seancës së mëparshme, ku ne kemi bërë një dëgjese në lidhje me prezantimin e projektligjit, do të kemi një prezantim të relatorit për amendamentet që kanë ardhur, më pas do ta marrë fjalën ministri, si dhe kolegët që kanë bërë amendamente.

Gjatë seancës së kaluar vetëm zoti Alibeaj e ka prezantuar amendamentin, ndërsa amendamentet e tjera janë depozituar në protokoll dhe në sekretarinë e komisionit.

Gjithsesi, për më tepër, fjala për zotin Ndreca.

**Plarent Ndreca** – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Ministër,

Siç e tha edhe kryetarja, duke filluar që nga seanca e mëparshme e këtij komisioni, kemi vijuar komunikimin me Ministrinë e Drejtësisë për të gjitha qëndrimet dhe mendimet që kishim, të cilat i shprehëm edhe në komision, por edhe për amendamentet që kishin propozuar kolegët në lidhje me projektligjin “Për dhënie amnistie”. Unë gjykoj se ky projektligj është shumë i rëndësishëm, pasi jo vetëm lehtëson punën e organeve ekzekutive penale dhe u jep frymëmarrje këtyre organeve, por njëkohësisht edhe organeve të drejtësisë, pra atyre të hetimit penal, por edhe të gjyqimit, patjetër, në frymën e humanizmit, lehtëson edhe ata persona që janë të dënuar dhe janë nën hetim për vepra të lehta penale, duke u mundësuar riintegrimin dhe rehabilitimin.

Unë do ta filloj nga disa ndryshime, të cilat, unë, si relator i këtij projektligji, kam gjykuar t’i prezantoj në komision dhe të marr mbështetjen e anëtarëve, propozime për amendime, të cilat në gjykimin tim, por edhe në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me ministrin, kanë përfshirë shumicën dërmuese të propozimeve që kanë bërë zoti Alibeaj dhe zoti Nallbati.

Pra, nëse ju e gjykoni të duhur, mendoj ta fillojmë nga nenet ku ne kemi vendosur që të bëjmë një amendim, apo kemi gjykuar që t’i kërkojmë komisionit miratimin e këtyre amendimeve.

Amendimi i parë, që ne konsiderojmë se duhet bërë, është afati i hyrjes në fuqi i këtij ligji, i cili, në gjykimin tonë, duhet të jetë në datën 31.01.2024. Pra, në tekstin e mëparshëm, për shkak se...

**Klotilda Bushka** – Tekstet e amnistisë, jo hyrja në fuqi?

**Plarent Ndreca** – Po.

Ndërkohë, në tekstin e propozuar ka qenë data 30.11.2023, sepse projekti atëherë kishte ardhur në Parlament, ne, në komunikim dhe në rakordim edhe me ministrinë, kemi menduar të jetë data 31.1.2024. Ndërkohë, ky ndryshim pasqyrohet në të gjitha nenet ku është përcaktuar data 30.11.2023, pra është kthyer në 31.1.2024.

Një ndryshim tjetër, që ne kemi rakorduar dhe gjykoj se është shumë i rëndësishëm, është te neni 3, pika 1, ku ndryshohen germat nga “a”-ja deri në “c”-ja, ku propozohet që përfitimi për personat meshkuj që vuajnë dënim me burgim deri në 3 vjet të shkojë në 4 vjet, njëkohësisht edhe për femrat e dënuara me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim deri në 4 vjet të shkojë në 5 vjet.

Gjithashtu, edhe në germën “c” të po këtij neni propozohet që personat meshkuj të dënuar me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u kanë mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 3 vjet, propozohet që të shkojë në 4 vjet. Po ashtu, edhe personave femra, dënuar me burgim, të cilave, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u kanë mbetur pa vuajtur nga ky dënim 4 vjet, propozohet dhe bëhet deri në 5 vjet.

Ndërkohë, lidhur me kriteret ndaluese, ka pasur amendime edhe nga zoti Alibeaj. Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë ka këto ndryshime: ndryshon germa “k” e projektligjit dhe hiqet vepra penale 238 “Kanosje për shkak të detyrës” (kjo ishte një ndër kërkesat e amendimit të propozuar nga zoti Alibeaj); neni 245/1, paragrafët 2 dhe 4: “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, si dhe është shtuar vepra penale, paragrafi i parë i nenit 263 “Organizimi, grumbullimi dhe manifestimi i paligjshëm i personave të armatosur”.

Ndërkohë, te neni 5 “Kriteret për përfitimin e amnistisë”, në pikën 2, germa “c” shfuqizohet. Pra, germa “c”, që parashikon personat e dënuar, akuzat ndaj të cilëve janë gjykuar sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, shfuqizohet. Në kuadër të barazisë bëhet zbritja e dënimit të padiferencuar edhe për subjektet që janë dënuar nga GJKKO-ja, përveç të dënuarve me burgim të përjetshëm dhe të dënuarve për krime kundër jetës ndaj personave në

rrethana cilësuese, funksionarë publikë, policisë, marrëdhënie familjare e të tjera. Pra, bëhet fjalë vetëm për ata, të cilëve u zbritet dënimi në mënyrë të njëjtë, pra ka një barazi në këtë pikë.

Ndërkohë, lidhur me kriteret për fitimin e amnistisë nga ndjekja penale, në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme: “Data e përjashtimit të subjekteve që janë ende nën hetim...”, siç e thashë, kalon në datën 31.01.2024.

Njëkohësisht, te veprat që nuk përjashtohen nga pushimi i ndjekjes penale, sugjerohet që komisioni të ndryshojë këto vepra: të hiqen veprat penale 90 “Rrahja”, 92 “Plagosja e lehtë nga pakujdesia”; të bëhet saktësim në nenin 112, paragrafi 1; të hiqet paragrafi 1 i nenit 236 “Kundërshtimi ndaj punonjësit të policisë së rendit”; të hiqet paragrafi 1, i nenit 238 “Kanosja për shkak të detyrës”, si dhe hiqen paragrafët 1 dhe 3 të nenit 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm për funksionarët publikë”.

Të tria këto ndryshime, në fakt, janë reflektim i propozimeve të deputetëve të opozitës, zotit Alibeaj dhe zotit Nallbati. Pra, për të mos e lexuar riformulimin, sepse besoj se u është dërguar nga koordinatori...

**Klotilda Bushka** – Tabela me propozimet u është shpërndarë të gjithë anëtarëve të komisionit.

**Plarent Ndreca** – Ndërkohë, pika 3 e nenit 6 ndryshohet si më poshtë: “Nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet, akuza penale ndaj të cilëve gjykohen, sipas përcaktimeve të germave “c” dhe “ç” të nenit 75/a të Kodit të Procedurave Penale”. Pra, hiqet parashikimi i projektligjit për mospërfitimin e subjekteve të deklarimit të pasurisë, sipas pikës 1 të nenit 6. Përjashtim bëjnë vetëm veprat që parashikohen në pikën 1, njësoj si edhe për subjektet e tjera.

Pra, ndërkohë që te pika 3 e nenit 6 parashikohej të përjashtoheshin të gjitha subjektet deklaruese të pasurisë, tashmë ato përjashtohen vetëm për veprën penale që lidhet me deklarimin e pasurisë, por jo për çdo veprë tjetër penale, e cila dënohet deri në 2 vjet. Pra, po flasim për vepra penale, të cilat dënohen deri në 2 vjet, por që nuk kanë lidhje me ushtrimin e detyrës apo me të qenit subjekt deklarues. Vetë vepra penale, që lidhet me deklarimin e rremë të pasurisë, është e përcaktuar dhe vijon të jetë një kriter përjashtues.

Në përmbledhje, unë si relator i projektligjit, ndryshimet që propozoj janë: efekti i amnistisë të jetë deri në datën 31.01.2024; të rritet me 1 vit përfitimi nga vuajtja e dënimit për burrat dhe gratë; të rritet me 1 vit përfitimi nga mbetja e viteve të dënimit për burrat dhe gratë; të hiqen disa vepra penale nga kriteri ndalues i përfitimit të amnistisë, si dhe të bëhen disa saktësime

në të; të zgjerohet fasha e përfitimit për zbritjen e dënimit me 1 vit, duke përfshirë subjektet që janë dënuar në mënyrë të posaçme; tek amnistia për ndjekjen penale bëhen ndryshime për subjektet e deklaramit të pasurisë, pra që janë përfitues të pikës 1, që përcakton kushtet përveç përjashtimit të neneve që ka kjo pikë, përfshirë nenin 257/a që lidhet drejtpërdrejt me deklaramin e pasurisë; të hiqen disa vepra penale, propozuar edhe nga deputetët, për ndjekje penale.

Kjo është pak a shumë, e nderuar kryetare, ajo çfarë ne kemi konkluduar gjatë gjithë kësaj jave, duke marrë në konsideratë amendimet e propozuara nga deputetët, në rakordim të plotë edhe me ministrin e Drejtësisë, për mundësinë që kishim për të ndërhyrë pa ndryshuar thelbin, qëllimin dhe objektivat e këtij projektligjit.

Nëse do të jetë nevoja që të përgjigjem për ndonjë pyetje, jam i gatshëm.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Ndreca!

Në vijim të parashtesës që bëri zoti Ndreca, ministër, fjala për ju, në lidhje me propozimet.

**Ulsi Manja** - Përshëndetje!

Zotërinj deputetë,

E nderuar kryetare,

Në fakt, ne kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me Komisionin e Ligjeve që javën që shkoi, ku na janë vënë në dispozicion të gjitha propozimet që kishin kolegët deputetë në lidhje me projektligjin për amnistinë, dhe i kemi rakorduar të gjitha ato që parashtrori edhe relatori, zoti Ndreca.

Në mënyrë të përmbledhur, dua ta nis shkurtimisht me amendamentet e deputetit Alibeaj. Propozimi i parë kishte të bënte me datën e amnistisë qoftë për personat e dënuar, qoftë për ata që janë për ndjekje penale gjatë tubimeve ose protestave politike të organizuara për periudhën 1.10.2018 deri më 31.12.2020. Natyrisht, e tha edhe kolegu Ndreca, ky propozim është pranuar, por jo duke përcaktuar limitin kohor, kjo do të shtrihet deri në datën 31.01.2024. Pra këtë kategori përfituesish nuk mund ta lidhim me një periudhë kohore, por do të jetë deri në datën kur vendimi ka marrë formën e prerë, që është data 31.01.2024. Ne e kemi pranuar që në parashtrimin tonë në parim se data që kjo amnisti i shtrin efektet do të jetë 31.01.2024. Pra, ky propozim është zgjeruar madje, me të gjithë gamën e personave të dënuar ose që janë në ndjekje penale, deri në datën kur vendimi merr formën e prerë për të dënuarit dhe për kallëzimet që janë depozituar në prokurori deri në datën 31 janar 2024.

Sigurisht, është pranuar edhe për veprat që lidhen me tubimet dhe protestat, këtu kam parasysh veprat penale bazike, që lidhen me organizimin e protestave; është pranuar ndryshimi për nenin 261, “Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, pengimi në ushtrimin e së drejtës për t’u shprehur, grumbulluar apo manifestuar; është pranuar ndryshimi në paragrafin e parë të nenit 261, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme” neni 262, është pranuar i gjithi; te neni 263 “Organizimi i grumbullimeve dhe manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të armatosur”, kemi pranuar ndryshimin në paragrafin e dytë, sepse paragrafi i parë u referohet personave të armatosur në protestë, që është krim, i cili dënohet deri në 3 vjet me burgim. Pra, ne kemi pranuar edhe paragrafin e dytë të nenit 263. Edhe këto kanë qenë pjesë e propozimeve dhe amendamenteve që ka propozuar deputeti Alibeaj. Sigurisht, nuk kemi pranuar veprën penale 237, “Goditja për shkak të detyrës”. Ne kemi kriter ndalues të gjithë kategorinë e subjekteve, jo vetëm për personat që kanë marrë pjesë në tubime apo protesta, qoftë personat e dënuar, qoftë personat që janë në ndjekje penale për goditje për shkak të detyrës, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore që kanë këto vepra, por edhe duke u nisur nga parimet që ka kjo amnisti, ne nuk e kemi pranuar për të gjithë kategorinë e subjekteve. Po ashtu edhe shkatërrimin e pronës me zjarr apo shkatërrimin e pronës, sigurisht, nuk i kemi pranuar.

U tha herën tjetër që amnistia është akt mëshire, por duhet të jetë i kujdesshëm, sepse interferon në punën e një sistemi të pavarur, që është sistemi i drejtësisë.

Një nga parimet e kësaj amnistie, që është listuar në nenin 1, është edhe mbrojtja e interesit publik dhe efienca e sistemit të drejtësisë. Në këtë kuptim, për këto vepra, jo vetëm për këta që kanë marrë pjesë në protesta, por për të gjithë kategorinë e subjekteve, ne kemi mbajtur linjën që kishim, ndërsa veprat penale që kanë të bëjnë me organizimin dhe tubimet politike, ne i kemi pranuar, përfshirë edhe afatin.

Po ashtu është pranuar edhe një amendament tjetër, që ka propozuar deputeti Bledion Nallbati, për të siguruar barazinë, pra është mbajtur në konsideratë barazia. Kjo ka të bëjë kryesisht me zbritjen e dënimit me një vit për burrat dhe një vit e gjysmë për gratë dhe vajzat. Pse e kemi pranuar këtë sugjerim? Nëse shohim kriteret ndaluese për përfitimin e amnistisë, po flasim gjithmonë për zbritje dënimit, kemi thënë personat e dënuar për veprat penale 79, 79/a, 79/b dhe 79/c të Kodit Penal, personat e dënuar me burgim të përjetshëm, dhe personat akuzat penale të të cilëve gjykohen nga GJKKO-ja. Këtë sugjerim e kemi pranuar, sepse, ndërkohë që ne i japim mundësi që të përfitojë zbritje dënimi një personit të dënuar për veprën penale të vrasjes, neni 76,

ia mohojmë këtë të drejtë një personi, që mund të jetë dënuar për një vepër krejtësisht të lehtë nga Gjykata e Posaçme. Ndaj sugjerimi dhe propozimi na është dukur në përputhje edhe me parimet, edhe me qëllimin që ka ky ligj amnistie.

Ka pasur një propozim për të rritur kategorinë përfituese në nenin 3, nga 3 vjet që ishte për burrat, në 4 vjet, dhe nga 4 vjet që ishte për gratë dhe vajzat, ta çojmë në 5 vjet. Edhe ky sugjerim, pasi jemi konsultuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për të ditur se cila është kategoria përfituese nga kjo rritje e marzhit të dënimit për personat e dënuar, i jep mundësi një numri më të madh të grave dhe të miturve që të përfitojnë nga amnistia, por rrit edhe kategorinë përfituese të burrat.

Edhe kategoria e personave që janë të dënuar për shkatërrim prone, shkatërrim prone me zjarr, kundërshtimi i punonjësve të policisë, goditje për shkak të detyrës, për shkeljen e rregullave për lëndët plasëse dhe lëndët shpërthyesë dhe neni 236, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik me dhunë”, e përfitojnë zbritjen e dënimit me një vit. Nuk përfitojnë plotësisht nga amnistia, por përfitojnë zbritjen e dënimit me një vit.

Ne i kemi rakorduar të gjitha këto ndryshime me relatorin dhe jemi dakord me sa parashtrohet nga relatori.

**Klotilda Bushka** - Falënderoj edhe ministrin, edhe relatorin!

Kolegë, keni një tabelë me tri kolona. Në kolonën e parë keni projektligjin, siç është paraqitur nga nismëtarët, në kolonën e dytë janë amendamentet dhe në kolonën e tretë është versioni që propozon relatori për ndryshime me amendamente në komision. Pak a shumë, edhe ministri, edhe relatori bënë një shpjegim të të gjitha çështjeve.

Nëse keni pyetje apo diskutime për secilin prej tyre, fjala është për ju.

Kush e do fjalën?

Zoti Alibeaj, fjala për ju.

Më pas fjalën e ka zonja Felaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit!

Sigurisht, ju e merrni me mend se interesi im në këtë rast dhe interesi i Partisë Demokratike është për amendamentet e paraqitura prej saj. Po ju bëj me dije se amendamentet tona, siç e theksova edhe në prezantim, ishin të bazuara në formën fillestare të paraqitur nga ana e qeverisë.

Më lini t’ju bëj një parantezë. Ju, në fillim të mbledhjes së komisionit, thatë se keni shpërndarë një material, një tabelë apo diçka të tillë, lidhur me amendamentet, në mos gaboj, të

relatorit apo të dikuajt tjetër. Po ju bëj të qartë se një material i tillë mua nuk më ka ardhur. Nuk e di, nëse vazhdon ende bllokazhi i sistemit të *e-mail*-it të Parlamentit...

**Klotilda Bushka** – Zoti Alibeaj, u ka vajtur të gjithë deputetëve. Ndoshta, duhet të rikonfiguroni *e-mail*-in edhe një herë, sepse ndërkohë *e-mail*-et punojnë.

**Enkelejd Alibeaj** – Nuk më rezulton që të më ketë arritur. Unë e di fare mirë që sistemi i *e-mail*-it të Parlamentit nuk funksionon edhe për shkak të hakerimit që ka ndodhur, por po ju bëj...

**Klotilda Bushka** – Jo, ka kohë që është rikonfiguruar dhe funksionon. Gjithsesi, do t’jua nis tani sekretaria në *Whats’App*.

**Enkelejd Alibeaj** – Kjo ishte e para.

Me këtë dua t’ju them se njohja ime me atë se çfarë relatori tha apo që u pohua edhe nga ana e ministrit m’u bë me dije tani. Megjithatë, nga ajo se çfarë arrita të kuptoj edhe nga shpjegimi i relatorit apo edhe nga pohimet e ministrit, së paku nga relatori, janë 5-6 amendamente, nëse do t’i konsideronim të tilla, që nga afati i hyrjes në fuqi, ndryshimet në nenin 3, përjashtim të disa dispozitave e me radhë. Sigurisht, ajo që më tërhoqi vëmendjen ishte shpjegimi, jo në detaje, i bërë nga ana e ministrit, sipas të cilit kuptoj që ka shtuar, për sa i përket periudhës së kohës, të cilën ne kemi propozuar në amendament, nga 31 dhjetori i vitit 2020 ka shkuar si datë deri në vitin 2024, që shkon, të themi, përtej interesit tonë, gjë që nuk kemi dashur ta shkruajmë. Po jua shpjegoj përse.

Logjika me të cilën kemi prezantuar amendamentet ka qenë që të targetojnë të gjithë ata shtetas shqiptarë të proceduar, të hetuar, të gjykuar apo të dënuar, që i përkasin vetëm kësaj periudhe gjatë së cilës Partia Demokratike, aleatët e saj apo edhe grupe të shoqërisë civile organizuan protestat. Kemi vendosur atë segment kohor për të lehtësuar edhe punën e organeve, nëse kjo amnisti do të miratohet, pra për të identifikuar qartësisht targetin e individëve që duhet të përfitojnë nga kjo amnisti. E konsideroj, në këtë situatë ku jam do të duhet të shoh një shpjegim, si një zgjatim apo zgjerim pa asnjë arsye. Në fakt, nuk e pranoj që amendamentin tonë ta marrë qeveria, nga njëra anë, dhe ta zgjasë efektin kohor nuk do të kishte sens në logjikën politike që ka paraqitur. Nga ana tjetër, vura re se nga ministri u tha se janë pranuar nenet 261, paragrafi 1, 262 dhe 263, paragrafi 2 dhe nuk janë pranuar nenet 237, 150, 151 e me radhë. Do të duhet të pranoj faktin që nga ana e qeverisë nuk është pranuar seti i dispozitave të plota të propozuara nga amendamentet tona. Sigurisht, nëse është kështu, është e udhës ta themi në mënyrë më të qartë.



Po ju bëj me dije edhe një herë që dispozitat, të cilat ne i kemi propozuar si amendamente, u referohen neneve 150, 151, 235, 236, 237 dhe 282 të Kodit Penal. Po jua sqaroj edhe një herë që identifikimi i këtyre dispozitave bazohet në të gjithë analizën që strukturat juridike të Partisë Demokratike kanë bërë lidhur me procedimet penale që kanë pësuar subjektet, të cilët janë thirrur në protesta nga ana jonë apo nga shoqëria civile në këtë periudhë kohore që unë jua bëra me dije. Nëse është kështu, më rezulton që nenet 261, 262 dhe 263, në fakt, ne as i kemi përmendur, kështu që duket se është një qëndrim nga ana e qeverisë me lugën bosh. Sigurisht, është e drejta juaj ta bëni këtë gjë.

Po ju kujtoj që unë i kam kërkuar ministrit të Drejtësisë në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, kur u bë prezantimi, duke qenë se është autoriteti ligjor, i cili do të mund të bënte një analizë të plotë të të gjitha subjekteve që ndodhen në njërin nga fazat e procedimit, hetim, në pritje të shqyrtimit në gjykim apo të dënuar, m'u premtua, në fakt, një gjë e tillë. Vetë zoti Ministër tha se ne kemi një listë nominale të të gjithë personave, të cilët përfitojnë, sipas variantit fillestar që ata kishin bërë, por unë besoj se kjo duhet të jetë kështu, nuk e kam marrë një material të tillë.

Gjithsesi, për ta konkluduar, shoh se nuk pranohet asgjë nga amendamentet tona, pra të paraqitura nga ana ime si përfaqësues i Partisë Demokratike. Zgjedhja juaj. Ne i qëndrojmë amendamentit të paraqitur, sigurisht duhet të them edhe atë gjënë tjetër, që në prezantim unë u kam lënë edhe mundësinë përfaqësuesve të qeverisë, që, nëse do të kishte ndonjë dispozitë penale, e cila aplikohet për ata shtetas shqiptarë, për vepra penale, të cilat kanë lidhje me organizimin e protestave dhe të tubimeve dhe vepra penale që rrethrotullohen rreth atyre ngjarjeve politike, sigurisht isha i hapur që ta pranoja. Unë nuk e kam një gjë të tillë. Ky është qëndrimi që mbani ju, por unë i qëndroj amendamentit që kemi paraqitur me ato dimensione kohore dhe të shtrirjes së veprave penale që janë përcaktuar në atë rast.

Sigurisht, pashë dhe vëreja, vertikalisht, në fakt, ishte edhe shpjegimi që u dha nga deputeti relator, se kishte edhe amendamente që i përkisnin edhe një kriteri ndalues, pra kriterit që u referohet ose vendimeve të dhëna nga gjykata e posaçme apo atyre që u përkasin subjektet, të cilët janë subjekt deklarimi, me fjalë të tjera politikanëve apo administratës së lartë.

Ne kemi qenë dakord me propozimin e sjellë nga qeveria, por çdo ndryshim tjetër e ul cilësinë e amnistisë dhe prek disa vija të kuqe politike. Jo ne, por Parlamenti do të duhet t'i ketë, se çfarë janë vepra penale që vijnë nga Gjykata e Krimeve të Rënda, dikur apo GJKO-ja sot dhe

që i përkasin kastës së politikanëve të mos preken nga kjo amnisti, gjithmonë në funksion të faktit që drejtësia do të duhet lënë e tillë që të mos interferohet nga ana e Parlamentit.

Ky është qëndrimi që unë kam lidhur me pozicionin e amendamenteve të reja apo edhe të qëndrimit ndaj amendamenteve tona të mbajtura nga qeveria. Gjithsesi, rezervoj të drejtën, besoj se do të ma krijoni këtë komoditet, që në formë të shkruar të gjitha qëndrimet e thëna, qoftë nga zoti Ndreca, qoftë nga zoti ministër të kemi mundësi t'i shohim dhe t'i analizojmë me qetësi.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Fjalën e ka zoti ministër.

Më pas zoti Ndreca.

Zonja Felaj, do ta merrni fjalën sapo të bëhet sqarimi në lidhje me pyetjet e zotit Alibeaj.

**Ulsi Manja** – Pa dashur të bëj replikë me kolegun Alibeaj, sepse kur të vijmë te diskutimi nen për nen ndoshta edhe do të qartësohet situata, lidhur me propozimin që ka bërë zoti Alibeaj, duhet të qartësojmë situatën për të dënuarit dhe për personat që janë në hetim apo gjykim. Për kategorinë e personave të dënuar, përveç afatit kohor që është pranuar dhe është shtrirë në kohë madje, përfitojnë të gjithë të dënuarit me përjashtim të atyre që janë dënuar për goditje për shkak të detyrës dhe shkatërrim të pronës me zjarr. E gjithë gama e veprave 150, 235, 236 dhe 282, paragrafi 1, janë kategori përfituese.

Ajo që ne nuk pranojmë për këtë kategori është ndjekja penale për ata që janë në hetim apo gjykim, sepse e kemi lidhur me veprat penale, të cilat dënohen deri në 2 vjet, madje edhe këtu me disa përjashtime. Por ama veprat penale që lidhen me tubimet dhe manifestimet e paligjshme, sigurisht janë përjashtuar edhe nga ndjekja penale, por ne nuk mundemi që të përjashtojmë nga ndjekja penale personat e akuzuar për shkatërrimin e pronës me zjarr, kundërshtimin e punonjësve të policisë dhe të rendit publik me dhunë apo goditje për shkak të detyrës, sepse kjo linjë është ruajtur për të gjithë kategorinë e subjekteve. Nuk e kemi ndarë ne në kategori përfituesish, të cilët kanë marrë pjesë në tubime dhe i kanë kryer këto vepra dhe kategori subjektësh, të cilët nuk kanë pjesë në tubime, por janë në hetim apo në gjykim për këto vepra. Pra, kemi ruajtur të njëjtën linjë që është në përputhje me parimet e kësaj amnistie.

Sa i takon dënimit, sigurisht janë kategori përfituese. Kjo do të sqarohet kur të shkojmë te diskutimi dhe votimi nen për nen i këtij projektligji.

Ndërsa lidhur me riformulimin e pikës 3 të nenit 6, që ka të bëjë me kategorinë e zyrtarëve të lartë, nga varianti ynë është se nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet që janë deklaruese

të pasurisë, pasi akuzat penale të tyre gjykohen nga GJKKO-ja. Sigurisht, ka një formulim të këtij paragrafi nga ana e relatorit.

Po jua sjell se cili ka qenë diskutimi me një shembull shumë të thjeshtë: një zyrtar i lartë publik akuzohet për një vepër që është në suazën e një kundërvajtjeje penale. E mora këtë shembull për t'ju thënë se çfarë synon riformulimi. Nëse në pikën 1 përfitojnë të gjithë personat, subjektet që për akuzat penale dënohen deri në 2 vjet burgim, edhe pse nuk kanë lidhje me detyrën përfitojnë, me formulimin e pikës 3, të nenit 6, zyrtarët publikë, që deklaronin pasurinë, nuk janë kategori përfituese.

Relatori ka një propozim që e lidh ngushtësisht me veprat penale që lidhen me detyrën. Shkronjat “c” dhe “ç” përfshijnë “zyrtarët e lartë” dhe “ish-zyrtarët e lartë publikë” që nuk përfitojnë nga pika 1 e nenit 6, që ka të bëjë me ndjekjen penale, për veprat penale që janë mbi 2 vjet dhe që lidhen me detyrën, por për një vepër tjetër të lehtë, që mund të jetë, le të themi “fyerje”, që është në gjykim, sigurisht edhe zyrtarët publikë, nuk ka arsye pse të diferencohen nga pjesa tjetër e shoqërisë. Ndërsa për veprat që lidhen ngushtësisht me detyrën dhe që dënohen me mbi 2 vjet burgim dhe që janë përfitues, sipas pikës 1 të këtij neni, ne dhamë dakordësinë për riformulimin që ka propozuar relatori, por, gjithsesi ngelemi të hapur për ta diskutuar kur të vijmë te diskutimi nen për nen, se cilat kanë qenë arsyet për këtë.

Ndërkohë, edhe pse është në nivelin e një kundërvajtjeje penale 287/a “Refuzimi për deklaram, fshehja e pasurisë” e gjitha është i përjashtuar, sipas pikës 1 të nenit 6. Pra, e kemi shtuar nenin **287, që ishte çdo 2 vjet** dhe që lidhet me detyrën, që mund të ishte kategori përfituese, e kemi futur si kriter ndalues. Gjithsesi, kur të kalojmë në diskutimin nen për nen, do t'i sqarojmë.

**Klotilda Bushka** – Zoti Ndreca.

**Plarent Ndreca** – Po e vijoj aty ku e la ministri. Zoti Alibeaj, ideja është kjo, nuk ka fare lidhje me politikanët (ndoshta nuk keni qenë i vëmendshëm, ose ndoshta për faktin që nuk ju ka ardhur *e-mail*-i dhe nuk e keni parë me kujdes) dhe subjektet e SPAK-ut.

Pra, pika 3 e nenit 6 kishte dy parashikime. Një parashikim që lidhet me subjektet deklaruese të pasurisë. Subjekte deklaruese të pasurisë janë jo zyrtarë të lartë, në kuptim të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, por janë zyrtarët e mesëm, që kanë detyrimin të deklarojnë, të cilët përjashtoheshin për vepra të lehta penale dhe dënohen deri në 2 vjet burg, dhe që nuk lidheshin fare me detyrën. Viojnë të qëndrojnë subjektet e posaçme dhe subjektet që gjykohen nga Gjykata e Posaçme dhe Prokuroria e Posaçme. Pra, këto subjekte nuk përjashtohen.

Të vetmet subjekte, të cilat edhe këto nuk përjashtohen tërësisht, por përjashtohen për ato vepra penale që nuk kanë lidhje fare me detyrën, janë ato që sqaroi me të drejtë ministri. Nëse një zyrtar i mesëm, një drejtor diku, ka bërë një aksident pa pasoja, do të përjashtohet nga përfitimi për shkak se thjesht është deklarues i pasurisë? Unë gjykoj që jo se nuk ka kuptim dhe nuk kanë as lidhje me njëra-tjetrën. Po jua theksoj edhe një herë tjetër që asnjëri prej këtyre nuk është politikan, sepse politikanët janë subjekte të posaçme, të cilët janë të përjashtuar nga pika 3, që vijon të jetë e njëjtë. Ky është sqarimi i parë.

Sqarimi i dytë është në lidhje me amendamentet. Unë nuk e kuptoj realisht, ndoshta mund ta bëjmë diskutim edhe më pas, se cilat janë nenet që nuk janë marrë në konsideratë. Për shembull, neni 150, të cilin strukturat tuaja juridike e kanë vendosur për ta hequr, edhe në projektin e parë të qeverisë ky nen nuk ka qenë përjashtues. Unë e kam këtu projektin e qeverisë dhe te neni 4, nuk është neni 150 si vepër penale e përjashtuar. Ju keni kërkuar përjashtimin, ndërkohë që nuk është as në projektin e qeverisë.

Neni 151, unë e kam Kodin Penal përpara, i Kodit Penal, nëse ju doni të përjashtoni ata, të cilët kanë vënë zjarr, është: shkatërrimi i pronës me zjarr. Ju e theksuat në diskutimin që bëtë në seancën e mëparshme të Komisionit, se qëllimi juaj ishte që të përjashtonit disa vepra penale që ju i etiketuat si “vepra politike”, pavarësisht se nuk më duket shumë korrekte, por çfarë rëndësie ka, thjesht për ta kuptuar, janë veprat penale që kanë lidhje me tubimet apo me ushtrimin e të drejtave politike nga qytetarët.

Shkatërrimi i pronës me zjarr nuk e kuptoj se çfarë lidhje ka me qëllimin që ju kishit? Pra, në nenin 151 thuhet: “Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i pronës me zjarr dënohet me gjobë ose burgim deri në 5 vjet. Kur nga vepra penale janë shkaktuar pasoja të rënda materiale dënohen me burgim deri në 10 vjet. Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shtetasve apo shëndetin e njerëzve dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet”. Neni 151 nuk ka asnjë lidhje me atë qëllim që ju kishit.

Ndërkohë, neni 235, që ju kishit kërkuar, është i përjashtuar. E kam propozimin tuaj këtu përpara.

Neni 236, siç e shpjegoi edhe ministri, i bëj këto ndërhyrje për të qenë konkret, “Kundërshtimi i punonjësve të Policisë së Rendit Publik”. Pra, në të thuhet: “Kundërshtimi që u bëhet punonjësve të Policisë së Rendit Publik me qëllimin për ta penguar atë për të kryer detyrën, sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit”.

Edhe kjo vepër penale nuk ka lidhje me atë çfarë ju trajtuat në seancën e parë, që ka lidhje me veprat penale, le të themi, politike, pra kundërshtimi i punonjësve në ushtrimin e detyrës nuk ka lidhje. Pra, ushtrimi i të drejtave politike, është një e drejtë qytetare, e cila ka disa kufij, kalimi i të cilëve mund të përbëjë një vepër penale, por kundërshtimi i punonjësve të policisë së rendit nuk ka lidhje me ato të drejta. Ndërkohë, neni 237 është hequr. Pra, një ndër kërkesat tuaja, që ka të bëjë me nenin 3, pika 1, siç e kërkoni ju, është hequr, e relatuam; mbetet vetëm neni 282 i Kodit Penal, sipas të cilit dënohet shkelja e rregullave me lëndët plasëse dhe djegëse. Po kjo çfarë lidhjeje ka me të drejtat politike?! “Shkelja e rregullave të caktuara për mbajtjen, prodhimin përdorimin, ruajtjen, transportimin dhe tregtimin e lëndëve plasëse ose djegëse dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet”. Nuk besoj se ne duhet të përjashtojmë këtë kategori personash, që nuk kanë lidhje me ushtrimin e të drejtave politike individuale, por kanë lidhje me shkeljen e rregullave për përdorimin e lëndëve plasëse dhe djegëse.

Këto janë propozimet tuaja, zoti Alibeaj, unë nuk kam nene të tjera, përveç këtyre në propozimin tuaj që kam këtu. Unë i numërtova të gjitha nenet, nëse ju keni ndonjë nen tjetër, që unë nuk e kam cituar, më thoni.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** - Po, zoti Alibeaj, një sqarim të fundit, dhe më pas zonja Felaj. Do t'i diskutojmë edhe gjatë shqyrtimit nen për nen të gjitha, në detaje, kështu që t'u japim mundësi të gjithë kolegëve.

Po, zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Së pari, e thashë pak më parë, unë nuk jam njohur me qëndrimet në formë të shkruar, kështu që, unë i rezervoj vetes që të njihem me to në formë të shkruar.

Megjithatë, për ato që duken si çështje të pakuptueshme qoftë për ministrin, qoftë për relatorin, së pari, nuk ju kam kërkuar zotërinj, as qeverisë, as Kuvendit, të bëni një supervizion mbi amendamentet tona, të cilat i sqaroj dhe i mbroj unë, pasi, siç e bëra në prezantim, po e bëj dhe tani.

Po marr dy shembujt e fundit që solli zoti Ndreca për nenin 235, që bën fjalë për kundërshtimin e punonjësve të policisë së rendit, dhe nenin 282, ku flitet për përdorimin e lëndëve plasëse. Po, jam dakord unë që në parim këto dy dispozita nuk duhet të amnistohen. Por, tek ajo që unë kam shkruar në dokumentin që duhet ta keni lexuar edhe në relacion, kam dhënë dhe logjikën e aplikimit të këtyre dispozitave. Kundërshtimi i punonjësve të rendit publik, por edhe

përdorimi i lëndëve plasëse e të tjerë me radhë u referohet vetëm atyre veprave penale, të cilat, në aspektin e fakteve, kanë lidhje me protestat e organizuara jo vetëm nga Partia Demokratike, por edhe nga shoqëria civile - kujtoj këtu rastin e vrasjes së të riut Klodian Rasha; rastin e shembjes së Teatrit Kombëtar, protestat e studentëve e me radhë - sepse ka ndodhur një fenomen i tillë, dhe e keni të shtruar në relacion.

Persekutimi që u ka ndodhur të gjithë këtyre protestuesve nga ana policisë (ju e dini fare mirë që referimi veprave penale para se të shkojnë në prokurori e gjykatë zanafillën e ka nga policia), si dhe për të qenë sa më shumë persekutues ndaj protestuesve, organet e policisë kanë vendosur edhe këto dispozita, pra nuk janë mjaftuar thjesht me faktin e organizimit dhe grumbullimit të tubimeve të paligjshme, që do të ishte, në fakt, dispozita themelore, por kanë përdorur dispozita gjithnjë e më ekstreme: nenin 235, që flet për kundërshtimin e punonjësve të policisë, nenin 282 për përdorimin e lëndëve plasëse e me radhë.

Pra, kolegë, nga analiza që kemi bërë ne, protestuesit e viteve 2018-2019-2020 e me radhë, në vend që të akuzoheshin për veprat penale, si: organizimi dhe grumbullimi i tubimeve, protestave të paligjshme, në fakt, janë akuzuar për vepra të tjera shumë më ekstreme. Ky është fakt. Ndaj edhe amendamentet tona targetojnë pikërisht grupin e protestuesve, së pari.

Së dyti, kemi vendosur limitin kohor, për të mos pasur asnjë lloj abuzimi, që tej këtij segmenti kohor apo përtej organizimit të protestave dhe tubimeve, askush tjetër të mos përfitojë. Jam dakord që një individ, i cili nuk ka pasur lidhje fare me protestat dhe tubimet politike të Partisë Demokratike apo të shoqërisë civile, një individ që ka përdorur dinamit diku, një individ që ka kundërshtuar forcat e rendit, pra nuk ka lidhje fare me protestat, nuk duhet të përfitojë (prandaj kemi vendosur dhe kriterin kohor).

Së treti, ajo që është e rëndësishme, unë ju thashë që ky relacion do të duhet të jetë pjesë e projektligjit, nëse do të miratohet, që t'u shërbejë edhe organeve të prokurorisë, edhe gjykatës për ta kuptuar më saktë dhe për të targetuar individët që do të duhet të përfitojnë.

Së katërti, ju thoni “përfitojnë”, do të thotë ata që janë dënuar, sipas variantit tuaj, ndjesë që jua them, por është një gjysmagjel, pra ata që janë dënuar për disa vepra penale përfitojnë; ata që janë në ndjekje penale nuk përfitojnë. Ju e kuptoni që është një dopio standard. Pozicioni ynë është i qartë: për të gjitha këto vepra penale, të neneve 150, 151, 235, 237, 282 e me radhë, për të mos i përmendur, kush është dënuar për to, përfiton, del nga burgu, e thënë me fjalë të thjeshta, dhe kush është në procedim penal, nuk duhet të procedohet. Kaq e thjeshtë është.

Kështu që, nuk jam me qëndrimin që të mund të bëjmë një, ndjesë për termin, allishverish, nuk jam për këtë. Këto vepra penale janë të natyrës politike, për shkak se njerëzit aty nuk kanë dalë në mënyrë individuale, nuk janë orientuar nga një frymëzim kriminal individual, jo. Unë e kam bërë të qartë edhe në relacion, janë thirrur në protesta dhe tubime të natyrës politike nga Partia Demokratike - po e sqaroj edhe një herë që përgjegjësinë politike të tyre e mbajmë ne – por, përkundër represionit policor ndaj këtyre shtetasve, ne kemi vendosur të mbajmë këtë lloj qëndrimi, që të përfitojnë nga amnistia me këto amendamente të thjeshta dhe të qarta që kemi prezantuar.

Kështu që, unë nuk kuptoj asgjë të komplikuar që ju keni shkruar në këto amendamente mbi amendamentet.

Edhe një herë, për procedurë, ju mund të bëni amendamentet tuaja, është e drejta juaj, nuk i futem fare këtij diskutimi, por mbi amendamentet tona nuk keni të drejtë të fusni duart: ato ose pranohen, ose nuk pranohen. Këtu çështja është e qartë edhe në aspektin juridik, edhe në aspektin juridik, nuk kemi pse ta komplikojmë më tepër se kaq. Ky ishte sqarimi që doja të bëja.

Thashë, edhe një herë, unë i rezervoj vetes t'i shoh dhe t'i analizoj edhe qëndrimet, apo amendamentet që ju keni bërë.

Së fundi, nëse e mbani mend, në prezantim në seancën e parë unë ju thashë që etika, legjitimiteti i një akti amnistues duhet të jetë i tillë, që të mos u adresohet përfitimeve individuale, pra me emra të posaçëm. Nuk do të ishte në nderin politik të askujt ta bënte këtë gjë, sidomos edhe procesi, të themi, i shtimit të amendamenteve, me emra bashkëlidhur pas, nuk do të ishte i moralshëm dhe hijshëm për askënd. Këtu na keni kundër. Jam i qartë në këtë pozicion.

Atëherë, unë do të duhet të marr kohë për të parë edhe qëndrimet tuaja të shkruara, të relatorit apo të ministrit, nëse janë të shkruara. Mbetem përsëri i paplotësuar në kërkesën time bërë qeverisë, pra ministrit, për të përcaktuar listën e plotë, siç ai tha, siç premtoi seancën e kaluar, të përfituesve të variantit fillestar të sjellë nga qeveria, dhe më pas do të kemi kohën tonë dhe do të jemi në pozicion për të diskutuar në mënyrë të plotë dhe ezauruese.

**Klotilda Bushka** – Zoti Alibeaj, ju qëndrimin e keni paraqitur edhe kur keni bërë amendamentin, edhe sipas procedurës, sepse amendamente nuk keni bërë vetëm ju, janë disa amendamente, që janë punuar nga relatori dhe nga ministria. Nuk ka po ose jo; ka disa parime ligji i amnistisë, të cilat janë parashikuar shprehimisht në projektligj, shihen të gjitha amendamentet që propozohen, në përputhje me frymën e këtyre parimeve, sigurisht ka edhe pranime të pjesshme,

ose nuk ka pranime, por nuk ka po ose jo. Argumentet besoj ishin shteruese edhe nga ministri, edhe nga zoti Ndreca.

Gjithsesi, kur të jemi në diskutimin nen për nen, materialin e kemi, mund t'i shohim më konkretisht.

Zoti Ministër, fjala për ju.

**Ulsi Manja** - Unë kam vetëm një fjalë për të shtuar: zoti Alibeaj tha se do të marrë kohën e tij për ta parë variantin përfundimtar të amendamenteve që janë propozuar dhe që janë pranuar. Sigurisht, është në të drejtën e tij, ai shprehet për amendamentet që ka propozuar vetë, por edhe ne kemi të drejtë të shprehemi për amendamentet e zotit Alibeaj, sepse teksti i amnistisë do të kalojë në Parlament dhe do të marrë 84 vota, që sigurisht ka propozime dhe amendamente edhe nga kolegët e tjerë.

Unë jam plotësisht dakord që ju i keni thirrur ata në protesta apo tubime politike, ju e thatë që mbani përgjegjësi politike, por akti i amnistisë, si një akt mëshire, ka lidhje me anën penale të kësaj veprimtarie. Ju i keni thirrur në protestë, por besoj se biem dakord që nuk i keni thirrur në protestë të hedhin sende, që i kanë kërcënuar jetën një punonjëseje policie duke i marrë tre gishta. Nuk besoj se jeni dakord të amnistohet një person, që ka shkaktuar plagosje të rëndë me dashje në një protestë politike, që e keni thirrur ju, dhe që është dënuar nga drejtësia për një krim të tillë, sepse një nga qëllimet e kësaj amnistie është edhe mbrojtja e interesit publik. Është në detyrën e Parlamentit dhe të çdo deputeti që ta mbrojë atë policen, që humbi gishtat në atë protestë, sepse një person i thirrur në një tubim publik përdori dhunë, duke i kushtuar gati-gati jetën një punonjëse policie apo një tjetre, duke i shkaktuar dëmtime në sy.

Për të qenë korrekt, ne i kemi marrë pjesërisht në konsideratë ato propozime, që shkojnë në të njëjtën frymë me parimet që ka kjo amnisti. Por, gjithsesi, kur të vijmë te diskutimet nen për nen, ne do të shpjegojmë edhe arsyet pse njëra është pranuar plotësisht, pse tjera është pranuar pjesërisht, gjithmonë duke i mbetur asaj që thamë në diskutimin në parim në seancën tjetër të Komisionit të Ligjeve, që duhet të mbajmë një balancë kur diskutojmë ligje të tilla të ndjeshme, që interferojnë edhe në punën e një sistemi tjetër, që është drejtësia.

Është akt mëshire, por një ligj amnistie përcjell edhe mesazh për opinionin publik, përcjell edhe një mesazh për sistemin e drejtësisë, pra përcjell dhe një mesazh qytetar, në thelb, akti i amnistisë.



Ne kemi argumentet tona për secilin nga amendamentet e kolegëve, jo vetëm të opozitës, por edhe amendamentet e kolegëve të mazhorancës. Ndoshta zoti Ndreca, si relator, do t'i parashtrojë kur të vijmë në diskutimin nen për nen, sepse ka deputetë në Komisionin e Ligjeve që janë propozues të amendamenteve, ne i kemi (*shkëputje interneti*) kolegëve tanë të mazhorancës me këtë amnisti, sepse bien ndesh me qëllimet që ka kjo amnisti dhe me parimet e kësaj amnistie.

Këtë linjë kemi ruajtur në trajtimin e të gjitha amendamenteve, por votën, sigurisht, në fund e kanë deputetët, këtë qëllim kanë.

**Klotilda Bushka** - Faleminderit!

Zonja Felaj, më pas zoti Majko.

Zonja Felaj, nuk dëgjoheni.

A ta marrë fjalën zoti Majko ndërkohë?

Po, zoti Mjako.

**Pandeli Majko** – Faleminderit!

U kërkoj ndjesë kolegëve, sepse mund të them gjëra që janë thënë edhe në seancën e kaluar, por dëshiroj të shpreh përkrahjen time për propozimet që kanë ardhur nga Ministria e Drejtësisë.

Sigurisht, ne mund të diskutojmë shtesa dhe prapashtesa, por mendoj se kjo na vë në një balancë pak delikate. Aktualisht ne mund të bëjmë propozime, por amnistia në asnjë rast nuk është fenomen politik.

Unë propozoj që Parlamenti, edhe me rastin e kësaj amnistie, t'i propozojë ministrit të Drejtësisë që amnistia të bëhet e përvitshme, për shembull, me rastin e festës kombëtare. Mbase për këtë mund të promovohet edhe një akt legal, që të përfshijë të gjithë aktorët që mund të japin opinion legal për këtë çështje dhe për festën kombëtare të ketë çdo vit amnisti. Kjo është një çështje, që ka të bëjë me mëshirën, por ka të bëjë edhe me politikën penale. Politika penale sot është një vlerësim, i cili duhet bërë në bashkëpunim të ngushtë me sistemin e drejtësisë. Jam i bindur se ministri ka pasur kohën e mjaftueshme që të bëjë konsultime qoftë me Prokurorin e Përgjithshëm, qoftë me KLP-në, qoftë me KLGJ-në, të cilët, në një mënyrë pak më të strukturuar, mund të bëjnë të mundur që çdo vit ne të kemi amnisti.

Mendoj se amnistia e përvitshme nuk duhet lënë në subjektivitetin e politikës. Jemi të mëshirshëm ne, e bëjmë këtë amnisti, nuk organizohemi ne mirë, nuk bëjmë kuorumin, dhe shtyj të shtyjme.

Kështu, krahas diskutimeve të natyrave që kanë të bëjnë me ndryshimin e neneve, unë do të mbaj pozicionin që vjen nga qeveria. Pse do ta bëj këtë? Nuk do ta bëj se jam thjesht përfaqësuesi i mazhorancës, por nuk dua që këtu diskutimet të orientohen sipas një subjektiviteti, që vjen nga radhët e politikës. Amnistia është politikë penale. Ajo duhet të bëhet e përvitshme. Nuk duhet të jetë një histori e mbingarkuar. Duhet të jetë pjesë e politikës penale. Mendoj se me këtë ne duhet t'i zh dramatojmë të gjitha këto historitë e ngarkesave mbi nene të caktuara.

Mendoj se këtë vit, nëse do të merret parasysh opinionimi im, mund të bëhet kjo amnisti, por mund të shikohet edhe një amnisti tjetër për festat kombëtare, që pastaj të përcaktojë ritualin në vazhdim. Amnistia nuk bëhet pse burgjet janë plot. Amnistia bëhet edhe për këtë arsye, por edhe si pjesë e një politike penale. Unë e përsëris, amnistia duhet të bëhet e përvitshme.

Ju kërkoj ndjesë që po jap këtë opinion, që normalisht duhej të diskutohej në seancën e kaluar, por mendoj se është e tepërt që ne tani të futemi në detaje të natyrave: do të amnistohen protestuesit nga kjo datë deri në këtë datë dhe do të lihen të paamnistuar disa protestues të tjerë nga kjo datë deri në këtë datë, sepse ashtu janë disa interesa politikë brenda opozitës.

Me shumë respekt do t'u lutesha kolegëve të kemi mirëkuptim dhe gjërat të përcaktohen sipas parimeve të qarta dhe me sa më pak subjektivizëm!

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Zonaj Felaj.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Unë do t'i ftoja kolegët, por edhe ju që të kalojmë në votimin në parim të projektligjit, sepse përmbajtja e fjalës së secilit tregon qartë që ne jemi dakord në parim me amnistinë. Përndryshe, do të më dukej absurde që ne vazhdojmë të bëjmë diskutime për nene të veçanta të projektligjit të amnistisë, të bëjmë amendime apo të diskutojmë për amendime, ndërkohë që nuk e kemi votuar në parim.

Jo vetëm në logjikën e Rregullores së Kuvendit, por edhe në logjikën e punës së këtij komisioni ne duhet të bëjmë votimin në parim, pastaj të fillojmë diskutimin nen për nen, sepse besoj se aty do të kuptohemi edhe më mirë, duke iu referuar jo vetëm tekstit të projektligjit që kemi përpara, jo vetëm tekstit të amendimeve të propozuara deri tani edhe në komisionet e tjera parlamentare, por duke iu referuar edhe Kodit Penal, që, për hir të së vërtetës, tek i cili për shkak

se ka pësuar ndërhyrje në vite, do të duhet të kemi një tekst të azhurnuar dhe të sigurohemi se po punojmë të gjithë mbi të njëjtin tekst, ndërsa flasim për dispozita të ndryshme të Kodit Penal.

Unë kam dy propozime në parim për këtë projektligj.

Propozimi i parë është për rishikimin e përkufizimit të personit që i është shmangur drejtësisë. Kështu siç është sjellë ky përkufizim mua më duket se brenda përmban disa kategori subjektive, qartazi subjektive, të cilat nuk di si mund të provohen dhe para kujt duhen provuar, aq më tepër që nga momenti që amnistia do të hyjë në fuqi, atëherë do të duhet organi i ekzekutimit të ndjekjes penale, në rastin që do të përfshihet dhe më shumë, por natyrisht edhe prokuroritë, që të nxjerrin vendimet përkatëse të përfitimit nga amnistia.

Këtu është thënë, për shembull, se “person që i është shmangur drejtësisë është personi i fshehur, i arratisur”, - është njëlloj termi që nuk e gjen në ndonjë ligj që ka lidhje me të drejtën penale- dhe po kështu “i shmanget me vullnet” (çfarë do të thotë “i shmanget me vullnet procedimit penal, ose ka dijeni ?”). Pra, të gjitha këto, në mendimin tim janë kategori subjektive, të cilat do të krijonin vështirësi dhe diskutim në zbatimin e ligjit të amnistisë. Kështu që, do t’ i ftoja edhe ministrinë, edhe kolegët që të ne *optojmë* për një përkufizim, të cilin e kemi përdorur më parë në disa amnisti. Unë po ju kujtoj amnistinë e vitit 2016, ku iu riktheva atij përkufizimi, e pashë, dhe përkufizimi është i zhveshur nga këto lloj kategorish subjektive.

Sugjerimi tjetër imi në parim është që, meqenëse në burgjet tona apo edhe në spitalin e burgut ka të dënuar, të cilët janë me dëmtime të përhershme fizike, mendore apo me sëmundje të pashërueshme, të bënim një amnisti edhe të këtyre personave. Besoj se do të ishte krejt normale dhe do të përkonte edhe me qëllimin e amnistisë që ne t’ i jepnim një vëmendje edhe kësaj kategorie ku, në informacionin tim apo në atë që të paktën është bërë publike, nuk më rezulton të jetë një numër i vogël i të dënuarve të tillë. Kështu që, duke marrë gjithmonë shembull edhe amnisti të tjera të miratuara nga ky Parlament, mirë do të ishte ta përfshinin edhe këtë kategori të të dënuarve.

Ndërsa propozimi im i tretë është një propozim të cilin unë po e bëj meqenëse u fol tani këtu për disa nene (edhe për shkak se unë, zonja kryetare, do të largohem për disa minuta dhe do të rikthehem sërish) dhe merr shkas nga një amendim që u përmend këtu, lidhur me përfitimin nga amnistia për mosvuajtjen e mëtejshme të dënimit nga personat e dënuar meshkuj, gra dhe të mitur. U propozua të rritet masa e dënimit e cila do të përjashtohet nga vuajtja e mëtejshme, duke u bërë 4 vjet për meshkujt, nëse nuk gaboje, dhe 5 vjet për gratë dhe të miturit. Në këtë logjikë, mendoj se duhet të tregohemi të kujdesshëm për ato çka diskutuam në lidhje me disa nene. Për shembull, ne

thamë që nenet 235, 236, 237, 238 i fusim te lista e dispozitave ndaluese, për të cilat nuk përfitohet nga amnistia. Unë do të thosha se brenda atyre dispozitave ka paragrafë për të cilët mund të përfitohet, sepse t'i falësh dikujt 4 apo 5 vjet dënim, ndërkohë që një veprë dënohet deri në 3 vjet apo edhe deri në 6 muaj, më duket se nuk jemi duke ruajtur drejt parimet të cilat shpallen qysh në hyrje të draftit të amnistisë. Kështu që, mendoj se mund t'i rishikojmë, pasi, edhe për shkak të ndërhyrjeve të shumta që ka pasur Kodi Penal, nuk ka shumë ekuilibër te dënimet brenda së njëjtës veprë sipas çdo paragrafi. Për këtë arsye kisha merakun të ndërhyja, sepse ndoshta ne aty do të gjejmë konsensus.

Edhe për propozimet që bëri zoti Alibeaj, me një pjesë të tyre bie dakord, por nuk bie dakord me faktin që të mos i prekim propozimet e tij. Propozimet i janë shtruar Komisionit, kështu që ne duhet t'i diskutojmë ato dhe duhet të shohim se deri në ç' pikë jemi dakord. Në fund të fundit, asgjë jona apo asgjë e propozuar nga opozita nuk do të miratohej, nëse ne nuk do të binim dakord në një shumicë që shkon deri në 84 deputetë, për Parlamentin e kam fjalën, por natyrisht na duhet edhe shumica në Komision për t'i miratuar ato. Gjithmonë në kuadër të këtij propozimi që u bë, nëse ne do të falim 4 apo 5 vjet burg për të dënuarit, atëherë unë do të propozoj që në nenin 5, ku bëhet fjalë për kushtet e dhënies së amnistisë nga ndjekja penale dhe ku flitet posaçërisht për përjashtimin nga ndjekja penale, nga vijimi i mëtejshëm i hetimit apo i gjyqimit, pa marrë ende formë të prerë vendimi, të mos përfshihen vetëm veprat penale për të cilat ligji parashikon dënim deri në 2 vjet, por po them deri në 3 vjet, sepse në Kodin Penal është një kategori veprash të cilat kanë dënime deri në 3 vjet dhe nuk kanë ndonjë rrezikshmëri aq të lartë, në raport me të gjitha ato që dënohen deri në 2 vjet. Në Kodin Penal ka edhe dënime të tipit 2 deri në 3 vjet dhe kam bërë habi kur i kam parë, por ja që ka. Kështu që, nëse shkojmë në këtë drejtim, të përpiqemi ta ruajmë gjithmonë anën tjetër, për ta ekuilibruar sa më shumë dhënien e amnistisë mes të dënuarve.

Faleminderit për vëmendjen! Realisht shpresoj të jemi sa më efektivë në të gjitha diskutimet tona!

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Felaj!

Jemi në diskutimin në parim. Zoti Alibeaj, diskutimet për nene të veçanta do t'i bëjmë sapo të bëjmë votimin në parim, për të mos marrë 2 herë kohë. Kështu që, zoti Alibeaj, po ju jap fjalën, nëse doni të diskutoni për projektligjin në parim.

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Sigurisht diskutimi në parim ka lidhje me diskutimin e brendisë së projektligjit. Fakti që Partia Demokratike ka paraqitur amendamente, diskutimi në parim apo aprovimi në parim i projektligjit është i spontuar, sepse ndryshe nuk do të kishim paraqitur amendamente dhe çështja që diskutohet, në fakt, është brendia. Vetëm fakti që zonja Felaj ndërhyri tani me disa sugjerime, të cilat m' u dukën me sens, pra fakti që i bëri tani tregon diçka, tregon që është e nevojshme të shihen në detaje amendamentet e sjella nga deputetët mbi projektligjin e qeverisë.

Së dyti, unë nuk thashë që i qëndrojmë në mënyrë strikte dhe fanatike propozimit tonë. Po ta kuptoni, thashë diçka tjetër. Unë nuk do të dëshiroja dhe nuk jam kurrsesi, si përfaqësues i Partisë Demokratike, që diskutimi në Parlament i amnistisë të shndërrohet në një diskutim (më falni për shprehjen!) “shto miell e shto ujë”. Unë i qëndroj pozicionit që, teksa qeveria ka sjellë versionin e saj fillestar, ajo ka bërë një analizë të plotë dhe të gjithanshme, të paktën siç u premtua nga ministri, për dimensionin e ndërhyrjes me ligjin e amnistisë. E shkuara në Parlament gjithmonë ka treguar që amendamentet sporadike të sjella nga deputetët nuk i shpëtojnë rrezikut që ato t'u adresohen emrave të veçantë. Le ta themi që edhe në të shkuarën ka ndodhur. Për shkak të votës që kërkohet, deputetët sjellin një amendament duke pasur në mendje emrin përkatës që duhet të përfitojë. Unë besoj që kjo është një sjellje së cilës duhet t'i shpëtojmë, prandaj edhe unë thashë që, teksa ne kemi sjellë amendamentet tona në grup dhe kemi vendosur edhe kritere të qarta, si kriteri i dimensionit kohor; referimi te protestat; dispozitat përkatëse; legjitimitimi, për shkak se ka qenë represioni policor ai që ka akuzuar protestuesit qoftë në kundërshtim të forcave të rendit, qoftë me përdorimin e lëndëve plasëse (nuk ka qenë e vërtetë, por ka qenë represioni policor i cili ka penetruar deri në hetim dhe në gjykim), të paktën duhet të përfitojë një grup i caktuar individësh pa emra konkretë. Besoj që kjo na nderon në qëndrimin tonë. Për sa i përket historisë që solli zoti ministër, sigurisht e kemi shprehur qysh në atë kohë keqardhjen për incidentin e ndodhur, por këtu po ju kujtoj që ka qenë policia ajo e cila në orën 5:00 të mëngjesit shkoi në bregun e lumit dhe nxori të ngratët nga shtëpitë e tyre, të ndërhuara me gjak dhe djersë, në një represion policor në kundërshtim me çdo rregull të Kushtetutës, të procedurës penale e me radhë. E njëjta situatë ishte edhe në rastin e banorëve të Astirit, e njëjta situatë me banorët e Shkozës, me studentët apo në rastin e irritimit masiv të të rinjve kur ndodhi vrasja e të riut Klodian Rasha. Tani, nëse duam ta fusim diskutimin në të tillë hulli, ejani ta bëjmë, çështje politike është, por për të mos shkuar në këtë hulli, unë e kam bërë më parë propozimin dhe sigurisht i qëndroj atij propozimi.

Siç e thashë, unë nuk futem aspak në qëndrimet dhe propozimet tuaja, është e drejta juaj. Unë nuk jam një individ, është një parti e cila për çdo amendament mban edhe përgjegjësi politike në të ardhmen, për impaktin që sjell, pasi është argument politik, gjë që ne nuk mund ta fshehim, por nuk mund të futemi në një proces ku çdo deputet i mazhorancës të sjellë një amendament aty dhe një amendament atje për interesin e tij personal, ndërkohë që për amendamentet tona praktikisht nuk pranoni asgjë. Kjo është e drejta juaj, ju keni votat dhe mund ta bëni këtë, por histori që të mund të miratohet një ligj me shumicë të cilësuar në Parlament, me “peshkim” votash individuale, unë nuk jua këshilloj. Ju mund ta bëni, por nuk do të ishte në të mirën dhe në legjitimitetin e një akti kaq sublim si amnistia. Pastaj kjo ngelet zgjedhja juaj.

Për ta mbyllur, për diskutimin në parim vota ime është pro, për sa kohë unë kam paraqitur një amendament. Ndërkohë, për diskutimin nen për nen po jua them qysh tani se do të marr të gjitha amendamentet që sjell zoti Ndreca, qëndrimin që ka mbajtur Ministria ndaj amendamenteve tona, por, nëse dëshironi, edhe ato që tha zonja Felaj më parë, nëse ato janë të dokumentuara, sepse m’u dukën interesante për saktësinë e zbatimit të amnistisë nesër, nëse miratohet, kur të miratohet.

Ky është qëndrimi im.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Zoti Manja, fjala është për ju.

**Ulsi Manja** – Për të qenë i qartë dhe i drejtpërdrejtë, në këtë vend dhe në këtë Parlament janë miratuar amnisti të cilat kanë rrokur vetëm personat e dënuar dhe nuk kanë qenë të plota edhe me ndjekjen penale. Ka pasur modele ku amnistitë kanë qenë edhe për të dënuarit, edhe për ndjekjet penale, por ka pasur edhe modele të amnitive që janë bërë të pjesshme vetëm për personat e dënuar. Në fund të fundit, ky është edhe qëllimi i amnistisë: të amnistojë personat e dënuar nga drejtësia për një vepër penale të caktuar, si një akt mëshire i Parlamentit për t’u falur tërësisht apo pjesërisht pjesa e pavuajtur e dënimit. Ajo nuk i ka shtyrë fare efektet mbi ndjekjen penale, sepse amnistia nuk ka dashur t’i heqë nga duart drejtësisë instrumentin e kontrollit gjyqësor mbi akuzat që ngrihen nga prokuroria. Kështu që, në Parlament janë votuar edhe modele të kësaj natyre të amnistisë.

Sigurisht, ne kemi statistika të kategorive përfituese për personat e dënuar, pasi kjo amnisti të marrë votën në Parlament, dhe i kemi shumë të sakta madje. Kemi kërkuar amnisti, sepse kemi 2200 persona të dënuar dhe 11 mijë persona të dënuar me shërbim prove. Nëse ky draft i amnistisë

do të marrë votën në Parlament, në këtë variant që propozohet, edhe me amendamentet e pranuar dhe të dakordësuara me relatorin, përfitojnë 700 persona të dënuar dhe 2500 persona në shërbim prove. Për shkak të zgjerimit të gamës së kategorisë përfituese për zbritjen me 1 vit dhe me 1 vit e gjysmë për gratë e të miturit, kategoria e përfituesve të cilët përfitojnë nga zbritja e dënimit shkon nga 1200 në 1600 persona të dënuar. Këto janë statistikat në lidhje me këtë amnisti, sa u takon personave të dënuar.

Lidhur me personat të cilët janë në hetim apo në gjykim, nëse tejkalojmë rregullin që do të amnistojmë veprat të cilat dënohen deri në 2 vjet në limitet e në suazat e një kundërvajtjeje penale, sigurisht nuk ka subjektivizëm. Nëse do të shkojmë përtej këtij marzhi, pra do të hyjmë në terrenin e amnistisë nga ndjekja penale të veprave penale që janë krime, sigurisht ky është një moment shumë delikat, është një vijë shumë delikate, që na interferon drejtpërdrejt në punën e sistemit të drejtësisë. Modelet e amnistive të mëparshme, të cilat i kanë rrokur të dyja fushat, pra edhe dënimin, edhe ndjekjen penale, kanë vendosur si limit ndarjen kundërvajtje dhe krime, sepse kjo e bën të lehtë zbatimin e kësaj amnistie, sa i takon ndjekjes penale. Këtë e kemi konsultuar edhe me organet e drejtësisë. Në relacionin që ne kemi dorëzuar në Kuvend, sigurisht, kemi mendimin e të gjitha institucioneve të drejtësisë. Pastaj, nëse do të hyjmë në terrenin që pse të mos e çojmë amnistinë nga ndjekja penale edhe për vepra që dënohen deri në 3 vjet apo edhe për vepra që dënohen deri në 4 vjet, apo edhe për vepra që dënohen deri në 5 vjet, sepse deri në 5 vjet kemi shkuar për amnistinë e grave dhe të vajzave të dënuara, kjo pastaj do të na fuste në një terren i cili do ta vështirësonte tej mase zbatimin e kësaj amnistie nga ata që ligji i ngarkon për zbatimin e saj.

Sigurisht, statistikat për personat që janë në ndjekje penale apo në hetim, lidhur me kategoritë e veprave “shkatërrim prone”; “shkatërrim prone me zjarr”; “kundërshtim i punonjësit të policisë”; “goditja për shkak të detyrës” apo “shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse dhe shpërthyes”, janë publike, i disponojmë si Ministri e Drejtësisë, sepse vit pas viti i marrim nga organet e hetimit. Këto statistika ua kërkuam për tubimet dhe organizimet e paligjshme, do t’ua kërkojmë edhe për kategorinë e personave që akuzohen për shkatërrim prone me zjarr, shkatërrim prone apo kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik, por nuk është ky thelbi i diskutimit për këtë tekst amnistie që kemi sjellë. Kategoritë përfituese për personat e dënuar në shërbim prove apo ata që përfitojnë zbritje të dënimit i kemi tërësisht të sakta dhe ua kemi vënë në dispozicion të gjithë kolegëve deputetë. Këtë doja ta sqaroja për kolegët, për opinionin publik, por edhe për

kategorinë përfituese të kësaj amnistie, që sot pret një dritë jeshile nga ky Komision i nderuar që të kalojë ky tekst dhe ky variant i amnistisë.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Ministër!

Atëherë, kolegë, duhet vetëm të qartësojmë që, në kuadër të diskutimeve dhe të votimit në parim, projektligji i amnistisë ka mbi 3 muaj që ka ardhur në Kuvend, të paktën është shpërndarë materiali dhe po diskutohet nga të gjithë kolegët në Komisionin e Ligjeve. Në ligj janë të qarta parimet e amnistisë, si humanizmi; arritja e qëllimit të dënimit; rrezikshmëria e ulët e personave që amnistohen; edukimi dhe rehabilitimi; mbrojtja e interesit publik; dhënia e mundësisë së integritit më të lehtë dhe më të shpejtë të të dënuarve të mitur dhe femra; rritja e eficiencës në sistemin e drejtësisë; mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Këto janë parimet, në bazë të së cilave janë parë të gjitha amendamentet e ardhura nga kolegët deputetë. Jo më kot është marrë e gjithë ajo kohë, janë marrë të gjitha ato të dhëna, statistika, konsultime, edhe nga informacionet që disponojnë organet e drejtësisë apo nga organet e zbatimit të vendimeve, për të kuptuar situatën. Amendamentet janë parë në frymën e parimeve të ligjit të amnistisë, zoti Alibeaj. Nuk ka asnjë amendament i cili të jetë parë ndryshe, si ju po përpiqeni të aludoni këtu. Do të doja t'i garantoja të gjithë kolegët e Komisionit të Ligjeve dhe publikun që çdo amendament i ardhur nga kolegët është parë me kujdes nga Ministria e Drejtësisë, nga relatori dhe nga institucionet me të cilat konsultohen, në frymën e këtyre parimeve.

Thënë këtë, nuk do të doja të hidhej këtu dyshim apo aludim i mosndjekjes së parimeve të ligjit të amnistisë për emra të përveçëm. Nëse ju keni ndonjë të dhënë të tillë, ju lutem, na e thoni, që të mos aludojmë në mënyrë të përgjithshme, sepse amnistia u shërben të gjithë qytetarëve dhe është një akt humanizmi, siç e thamë. Kjo nuk do të thotë që personat, të cilët do të përfitojnë nga ky akt humanizmi, nuk i kanë kryer ato gabime. Edhe këtë duhet ta ketë të qartë shoqëria. Pra, ato gabime janë kryer për sa kohë që ka vendime të formës së prerë. Sigurisht, në kuadër të uljes së këtyre dënimeve apo të përfitimeve nga amnistia, merren në konsideratë disa kritere që parashikon vetë amnistia, si institucion juridik.

Edhe unë jam dakord që amnistia është një vullnet politik dhe biem dakord me opozitën që vullneti ynë politik është pa diskutim të lehtësojmë ato vepra të cilat janë kryer nga protestues gjatë tubimeve politike, për të cilat ka vendime gjyqësore të formës së prerë, por ne nuk jemi dakord që të përfitojnë nga amnistia personat e dënuar apo në ndjekje për dëmtim të punonjësve të policisë. Pavarësisht keqardhjes që ju shprehni, nuk është e mjaftueshme, sepse në kuadër të



vullnetit politik ka disa vepra për të cilat duhet të jemi të gjithë në një mendje se si do të trajtohen nga ligji i amnistisë, duke marrë në konsideratë që vendimet e gjykatave i kanë vërtetuar faktet dhe i kanë dhënë dënimet. Qytetarët duhet ta kuptojnë që ato janë vepra të gabuara, pavarësisht se amnistia u jep mundësinë e përfitimit. Pra, kjo do të thotë që, nëse ato përsëriten në të ardhmen, ata përsëri do të dënohen. Qytetarët duhet të edukohen me faktin që amnistia nuk është akt faljeje i përjetshëm, por është një akt humanizmi, i cili, në bazë të disa parimeve, tenton të arrijë disa përfitime që janë edhe në kuadër të rehabilitimit dhe të edukimit të të dënuarve; edhe në kuadër të rritjes së eficiencës në sistemin e drejtësisë dhe në zbatimin e vendimeve penale apo në menaxhimin e sistemit tonë penitenciar, në kuptimin e kushteve ku, siç e tha edhe ministri herën e shkuar, kemi një mbingarkesë; edhe në kuadër të mbrojtjes më të lartë të interesit të fëmijës, të grave e të burrave, por kurrësi kjo nuk shihet me emra të përveçëm të individëve. Kjo është një çështje e cila kërkon të udhëhiqet nga parimet strikte të parashikuara në Kushtetutë dhe në të gjithë kuadrin tonë ligjor për amnistinë. Fakti që kemi mendime të ndryshme nuk do të thotë se do ta bindim njëri-tjetrin. Secili ka argumentin e vet, por kjo nuk nënkupton që duhet ta paragjykojmë punën e njëri-tjetrit.

Unë do t'i falënderoja ministrin e Drejtësisë, relatorin dhe të gjitha institucionet e drejtësisë, me të cilat është konsultuar jo vetëm projektligji, por edhe amendamentet e kolegëve deputetë, gjithashtu edhe institucionet e zbatimit të vendimeve, të cilat kanë dhënë detajet përkatëse sa u takon statistikave, për të kuptuar drejt se cilat janë efektet pozitive që vijnë nga kjo amnisti.

Thënë këtë, kolegë, do t'ju ftoja të kalojmë në miratimin në parim të projektligjit dhe më pas në votimin nen për nen. Ju lutem, kolegë, dilni me kamera! Kush nuk mundet të dalë me kamera për efekt të lidhjes, nëse është kundër, të shkruajë në grupin e komunikimit të mbledhjes. Kush mundet, ju lutem, të dalë me kamera!

Kalojmë në votimin në parim. Kuorumi është në përputhje me ligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për dhënie amnistie”?

Atëherë, janë 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Të gjithë kolegët e kanë tabelën, sekretaria është kujdesur që ta dërgojë edhe në *e-mail*-et personale të kujtdo që ka probleme dhe nuk ka marrë *e-mail*-in zyrtar.

Në nenin 1 të projektligjit “Qëllimet dhe parimet e ligjit”, kudo në tekstin e projektligjit afati 31.11.2023, që ka qenë afati sa u takon efekteve të amnistisë, do të zëvendësohet me afatin 31.01.2024.

Po, zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Edhe një herë, sepse në kushtet në të cilat zhvillohet mbledhja ka vështirësitë e veta...

**Klotilda Bushka** – Mirë do të ishte të ishim fizikisht në sallë.

**Enkelejd Alibeaj** – Kërkoja Kryetares së Kuvendit, sepse e kam bërë disa herë kërkesën për të sjellë normalitetin në funksionimin e Kuvendit dhe të komisioneve.

**Klotilda Bushka** – Arsyetim tjetër ky, zoti Alibeaj, sepse është kollaj të drejtojmë gishtin tek të tjetër, por do të ishte mirë të kishte një dialog më të hapur të të gjithëve për t’u kthyer në normalitet. Gjithsesi, vijoje!

**Enkelejd Alibeaj** – Sigurisht, do të duhej që të hiqnit ju dorë nga interesi juaj për ta bërë Parlamentin në këtë mënyrë.

**Klotilda Bushka** – Zoti Alibeaj, ju lutem, se...

**Enkelejd Alibeaj** – Atëherë, mos më komento çdolloj fjale që them.

**Klotilda Bushka** – Sigurisht, sepse po flisni për autoritetin e Kryetares së Kuvendit, duke e ditur shumë mirë se çfarë kompetencash ka dhe se sa të ngushtë e ka fushën e veprimit në këtë rast, ndërkohë që dihet pse bëhet kjo situatë.

**Enkelejd Alibeaj** – Parlamenti nuk është vetëm i zonjës, por i të gjithëve.

**Klotilda Bushka** – Të mbahemi te thelbi!

**Enkelejd Alibeaj** – Në lidhje me diskutimet e bëra pak më parë për miratimin në parim, unë e thashë, për sa kohë kemi sjellë amendamentet tona, sigurisht kemi qenë dakord për diskutimin dhe miratimin e një ligji për amnistinë. Madje ju bëra me dije, duke marrë shkas edhe nga fjala juaj kur thatë se është studiuar dhe analizuar, në fakt, është e vërtetë, sepse ka 3 muaj e ca që ligji “Për dhënie amnistie” është depozituar, por (për publikun është e qartë tashmë) vetëm në këtë seancë të sotme pati së paku 2 apo 3 kolegë që bënë amendamente. Kur unë thashë që nuk duhet të bëjmë sjellje të tipit që shtojmë apo heqim dispozita, duke pasur në mendje emra përkatës, këtë kisha në mendje, këtij kurth duhet t’i shpëtojmë.

Ndaj, unë e përsëris kërkesën time, për të gjitha amendamentet e sjella dhe të prezantuara sot qoftë nga ministria, qoftë nga zoti Ndreca, qoftë nga zonja Felaj, flas për diskutimin nen për

nen, duhet kohë, sepse duhet seriozitet në diskutimin dhe analizën e këtij projektligji. Nuk mund të ecet me shpejtësi, sigurisht duke marrë përsipër edhe qëndrimin që ju keni, i cili me sa duket është i qartë, do të tarojmë pozicionin tonë.

Kështu që, kërkesa ime procedurale është që të na jepet kohë për t'i studiuar edhe një herë variantet e reja të projektligjit "Për dhënie amnistie", sepse praktikisht në amendamentet që na janë sjellë nga qeveria apo mazhoranca është një version të ri.

Unë kërkoj që të mos ecim me diskutimin nen për nen, por t'i shohim të gjitha këto amendamente që keni sjellë, të shohim edhe qëndrimin, me sa duket refuzues, ndaj amendamenteve tona, pastaj të lëmë një seancë tjetër për të parë dhe mbajtur një qëndrim final për diskutimin nen për nen.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zoti Alibeaj, ne gjithë ditën sot mund të bëjmë diskutime, duke u fokusuar te secili nen, tek të gjitha propozimet, sepse të gjithë kolegët tashmë janë në dijeni të tabelës.

Ne mund të rrimë dhe të sqarojmë çdo detaj në secilin nen, sepse edhe sikur ta bëjmë nesër do të ngrihet një koleg tjetër, i cili do të bëjë një propozim tjetër dhe kjo gjë nuk do të mbarojë kurrë.

Ne prandaj sot kemi lënë vetëm një pikë në rendin e ditës, projektligjin "Për dhënie amnistie", që të merremi me detaje për secilin nen.

**Enkelejd Alibeaj** – Zonja Bushka, një gjë po jua them qartë: nëse ju doni të miratoni projektligjin "Për dhënie amnistie" me elementet befasie, shpejtësi, mund ta bëni.

**Klotilda Bushka** – Zoti Alibeaj, ju e dini shumë mirë që nuk ka fare lidhje as me shpejtësinë, as me befasinë, projektligji "Për dhënie amnistie" ka 3 muaj që pret në Kuvend.

**Enkelejd Alibeaj** – Unë po ju ofroj mundësinë që ta diskutojmë, duke i dedikuar kohën e duhur një projektligji i tillë. Kjo është kërkesa që kam unë.

Këtë punën e 3-muajshit e përsëris edhe një herë, vetëm nga amendamentet që u sollën sot për 6 nene që janë aty, ku u sollën 6 amendamente nga zoti Ndreca, 2 apo 3 amendamente nga zonja Felaj, si dhe disa të tjera nga zoti ministër, kjo praktikisht është një situatë e re. Tani, edhe për t'i shërbyer publikut, duhet ta bëjmë të qartë se cili është versioni i ri i projektligjit "Për dhënie amnistie" të sjellë nga qeveria.

**Klotilda Bushka** – E kuptova kërkesën tuaj.

Faleminderit, zoti Alibeaj!

Të gjitha amendamentet e paraqitura janë në tabelë, të arsyetuara dhe të paraqitura në formën finale në kolonën e 3-të. Amendamentet e zonjës Felaj ishin në formën e propozimeve për shqyrtimin në parim, të cilat, në fakt, janë diskutuar paraprakisht me relatorin. Ne sot kemi gjithë ditën në dispozicion për t'i kushtuar rëndësi secilit nen bashkë me amendamentet. Nëse fokusoheni dhe nuk e harxhojmë kohën me diskutime, të cilat nuk lidhen me nenin, ne do t'ia dalim të qartësojmë të gjithë anëtarët e komisionit, por edhe publikun për secilin parashikim që bëhet.

Vijojmë me nenin 1, ku bëhet fjalë për ndryshimin e efekteve të amnistisë, nga 13.11.2023, që ishte në versionin e mëparshëm, më 31.01.2024.

Nëse relatori, Plarent Nderca, do të dojë ta marrë fjalën për secilin amendament në kolonë, i lutem ta kërkojë, në rast të kundërt, unë do të kaloj në votim.

A ka ndonjë sugjerim nga kolegët për këtë nen? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votim.

A jeni dakord me nenin 1, sipas versionit të sjellë nga qeveria, me propozimin e relatorit për datën e re të përfitimit të amnistisë?

Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Zoti Ndreca, a do ta shpjegoni nenin 2?

**Plarent Ndreca** – A dëgjohem?

**Klotilda Bushka** – Po.

**Plarent Ndreca** – I vetmi ndryshim është data, që ju e thatë, domethënë te pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohet data, nga 13.11.2023 bëhet më 31.01.2024. Ky është ndryshimi në nenin 2 “Përkufizimet”.

**Klotilda Bushka** – Dakord.

Para se ta kaloj në votim, zoti Ministër, nëse keni diçka për të thënë, ju lutem, ngrini dorën që të merrni fjalën, por besoj se deri këtu ministria dhe relatori janë dakordësuar.

Zoti Alibeaj, a keni gjë për të thënë për nenin 2?

Po, fjala për ju.

**Enkelejd Alibeaj** – E kam për nenet 1, 2 dhe për të gjitha nenet e tjera. Me sa kuptoj, kërkesën time, që të na lini kohë për ta parë, jo vetëm mua, por të gjithë deputetëve, nuk e pranuat,

e rrëzuar, duke qenë se e kaluar në votim me forcën e kartonëve. Nëse doni të vazhdoni, mund të vazhdoni...

**Klotilda Bushka** – Nuk e hodha fare në votim për të mos e pranuar, zoti Alibeaj, ju shpjegova arsyen pse vijojmë.

**Enkelejd Alibeaj** – Ju e hodhët në votim, se u duk që është votim.

**Klotilda Bushka** – Jo, nuk e hodha në votim propozimin tuaj për ta shtyrë, kërkoj pak mirëkuptim në një ligj kaq të rëndësishëm si ky...

**Enkelejd Alibeaj** – Unë bëj një kërkesë, që përfshin nenin 1 deri te neni i fundit. Të lutem, të mos i bëjmë gjërat sikur nuk i kuptojmë!

Kërkesa ime është: për diskutimin nen për nen, që fillon nga neni 1 deri në fund, kam nevojë për kohë të mjaftueshme për ta diskutuar dhe analizuar versionin e ri të amnistisë, që ju keni sjellë. Pranohet apo nuk pranohet, ju lutem, vendoseni diçka, meqë keni forcën e kartonit.

**Klotilda Bushka** – Zoti Ndreca ka kërkuar fjalën, pastaj ministri.

**Plarent Ndreca** – Duke u munduar që ta mirëkuptoj zotin Alibeaj, si dhe duke mos cenuar eficiencën në punën tonë, se në fund të ditës ne jemi këtu për t'i kaluar aktet, për më tepër këtë akt që ka 3 muaj që është në komision dhe në Kuvend, nëse zoti Alibeaj e ka të mjaftueshme një periudhë kohore në orë, dhe ne të rikthehemi brenda ditës së sotme, që ai t'i shikojë me stafin e tij të gjitha propozimet që kemi bërë, përfshirë edhe propozimin e zonjës Felaj, atëherë edhe ne po marrim 2-3 orë për këtë çështje, por pa e humbur ditën e sotme, për shkak se tashmë jemi mbledhur.

Mirë do të ishte që ne t'i kalonim dhe të mos ngeleshim peng i 2 apo 3 neneve, se praktikisht këtu përmbledhet e gjithë gjëja, aty bëhet i gjithë diskutimi apo moskuptimi i situatës. Nëse ju ose kolegët e vlerësojnë, unë do ta konsideroja të arsyeshme që t'i jepej një kohë, por pa humbur ditën e sotme, me qëllim që të dalim me një produkt.

**Klotilda Bushka** – Më duket propozim i arsyeshëm.

Zot Manja, a jemi disponibël sot, nëse e shtyjmë dy orë mbledhjen?

**Ulsi Manja** – Unë jam tërësisht në dispozicion të Komisionit të Ligjeve për shqyrtimin e tekstit të amnistisë. Por më duhet të theksoj, edhe në përgjigje të zotit Alibeaj, se nuk ka asnjë amendament shtesë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë mbi tekstin e projektligjit, janë amendamente të konsultuara me Ministrinë e Drejtësisë të depozituara nga deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Që të jem i qartë, Ministria e Drejtësisë ka tekstin e vet, të depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, sipas atij varianti që ka kaluar edhe në Këshillin e Ministrave. Ato që janë shtuar në tekstin e amnistisë janë amendamente, të propozuara nga deputetët dhe sigurisht të dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë, si propozuese e këtij projektligji. Pra, nuk ka amendament Ministria e Drejtësisë.

**Klotilda Bushka** – Është e qartë, zoti ministër, që Ministria e Drejtësisë nuk ka amendament, sepse Ministria e Drejtësisë ka sjellë nismën, projektligjin, kurse amendamentet janë të kolegëve deputetë dhe të trajtuara në dakordësi me Ministrinë e Drejtësisë, nëse janë apo jo në përputhje me parimet e amnistisë dhe nëse ka një vullnet për t'i pranuar.

Me mirëkuptim mbledhjen do ta shtyjmë për në orën 13:30, që t'i japim kohë zotit Alibeaj të konsultohet edhe me kolegët e vet.

Zoti Alibeaj, po e kërkonti prapë fjalën?

**Enkelejd Alibeaj** – Kërkesa ishte imja dhe ju ftoj të jeni seriozë.

Unë bëj kërkesën dhe ju keni një ngut për t'i kaluar ligjet me shpejtësi, siç duket e keni bërë rrugë këtë, është çështja juaj, por po e përsëris edhe një herë, do të duhet kohë e mjaftueshme. Këto historitë me 1 orë, 1 orë e gjysmë, apo 3 orë pa një çerek mund t'i bëni vetë ju.

Unë kam bërë një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë që në seancën e parë. Ajo më premtoi se ka numrin, emrat përkatës të përfituesve. Për të qenë korrekt dhe serioz, siç pretendoni të jeni edhe ju, do të doja ta kisha këtë të dhënë, por nuk e kam.

E dyta, tani po dëgjoj që nuk ka amendamente nga ana e ministrisë, por ka amendamente mbi amendamentet tona. Sigurisht, janë amendamentet tona, ndaj më duhet kohë e mjaftueshme për të parë qëndrimet tuaja dhe impaktin mbi numrin e përfituesve ose jo të amendamenteve tona.

Kështu që, me këto 2 orë apo 3 orë, na e kurseni humorin e zi. Kohë ka, ka tre muaj që ka ardhur projektligji “Për dhënien e amnistisë” dhe pse paskeni premtuar në publik se doni ta kaloni shpejt e shpejt të enjten, është puna juaj, por ky nuk është interesi i qytetarëve.

Së pari, do të doja t'i kisha të gjitha amendamentet e shkruara, e përsëris edhe një herë, jo vetëm të zotit Ndreca, por edhe të zonjës Felaj, sigurisht edhe qëndrimin, se ky është i rëndësishëm, tuaj, të qeverisë apo të kujtdo tjetër mbi amendamentet tona. Ne duhet të bëjmë një analizë të plotë dhe të lëmë një seancë një ditë tjetër, pasi duhet kohë. Unë nuk jam dhe nuk do të më keni asnjëherë për të ecur me shpejtësi dhe me drita ndezur për një ligj kaq të rëndësishëm. Unë e konsideroj të rëndësishëm, për ju është çështje vlerësimi.

Këtu po e mbyll diskutimin tim, nuk e marr më fjalën, nuk jam më pjesë e diskutimit nën për nen, jam në pritje të të gjithë setit të madh të dokumenteve që, me sa duket, keni prodhuar me njëri-tjetrin.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zoti Alibeaj, materialin e keni në e-mail-in personal, setin e madh, tabelën që kanë të gjithë kolegët, e cila është më se e qartë. Jeni jurist, nuk është ndonjë volum kaq i madh pune, që të kërkojë kaq shumë ditë, siç pretendoni ju, për më tepër janë çështje që ne i kemi diskutuar në parim dhe janë paraqitur nga kolegët edhe në protokoll më përpara, madje edhe nga kolegët e PD-së, jo vetëm nga ju, se ka edhe kolegë të tjerë që kanë paraqitur amendamente.

Mua më duket që po marrim kohë më shumë me këtë çështje se sa me thelbin dhe është më shumë një kërkesë për të pasur disa qartësime. Po, jam dakord me relatorin, që t'ju jepet mundësia për disa orë sot, prandaj propozova një orë.

Shoh që e ka kërkuar fjalën edhe zoti Majko, edhe ministri.

A ta marrë zoti Majko njëherë fjalën, pastaj ministri?

Zoti Majko e ka kërkuar fjalën në disa momente, por mua me kishte shpëtuar.

Më falni, zoti ministër!

**Pandeli Majko** – Është shpengim nga rrethana që nuk varen nga ne.

Unë mendoj se oferta juaj për zotin Alibeaj ishte e qartë, ai nuk pranon, ndaj mund të vazhdojmë me diskutimet nën për nen, nuk kemi pse të shtyjme mbledhjen për në orën 13:00.

Nëse zoti Alibeaj do të shohë se nga ajo që do të miratojmë ne do të ketë ndonjë prurje apo ndërhyrje, e cila vlen të diskutohet, ne në seancë do të jemi absolutisht të gatshëm ta rivlerësojmë atë. Nuk kemi pse ta shtyjme për në orën 13:00, kemi tre muaj që e kemi këtë dokument nga Ministria e Drejtësisë. Duhet të jesh atje në burg që të dëgjosh për amnistinë dhe kur dëgjon për amnistinë, duke qenë në rrethanat e burgut, kam përshtypjen se dita duket javë, java muaj dhe muaj vit. Kështu që, mendoj të procedojmë me këtë procedurë, pasi po diskutojmë për një akt, që nuk ka të bëjë me rrethana të thjeshta administrative, por me fate njerëzish.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Majko!

Po, zoti ministër.

**Ulsi Manja** – Në mbështetje të asaj që tha edhe deputeti Majko, nëse ka një ligj amnistie, që ka marrë të gjithë kohën e nevojshme, jo vetëm të diskutimit ndërmjet deputetëve dhe grupeve

parlamentare, por edhe të opinionit publik, është ky tekst amnistie. Ka 3 muaj që diskutohet dhe sot është çështje qasjeje dhe vullneti: a do ta japësh votën për këtë tekst për amnistinë, që kjo kategori përfituese, sipas këtij ligji, përfitojnë, apo nuk do ta japësh? Të gjitha të tjerat janë artifica politike, për shkak se ky ligj do 84 vota, pra do shumicë të cilësuar për të kaluar në seancë plenare. Por, ky tekst amnistie, ky variant i projektligjit nuk votohet nëse ngulet këmbë: ose kështu si them unë, ose nuk ka.

Ndërkohë, jam plotësisht dakord me ato që tha zoti Majko, që duhet ta vëmë veten në pozitën e atyre që kanë dy vjet që presin këtë amnisti, sepse u bë një kohë relativisht e gjatë që nuk ka pasur amnisti penale në këtë vend. U bë një amnisti i pjesshme fill pas pandemisë, por ka qenë një amnisti, nga e cila kanë përfituar një kategori shumë e vogël personash. Ndërsa, ky projektligji i jep mundësi një mase të konsiderueshme të dënuarish që të përfitojnë nga ky akt mëshire. Po thuhet “akt mëshire”, por kur bëhet me kushte, nuk quhet më akt mëshire, sepse e kthen këtë ligj amnistie në kauzë politike, për qëllime të përfitimit politik.

Prandaj, dua ta mbështes edhe atë që tha zoti Majko, që t’i kthehemi traditës për të pasur çdo vit një akt amnistie. Nëse themi që është akt mëshire, akt humanizmi i shoqërisë, Parlamenti do të duhet ta kthejë në traditë këtë gjë.

Tani thuhet “duam kohë, “nuk duam kohë”, por mendoj që është koha për të rënë në grackën e allishverisheve dhe jo e kundërta.

Ne ju kemi vënë përpara një projektligj për amnistinë, për të cilin ne kemi vënë në dispozicion statistika të qarta për personat e dënuar, se, në fund të fundit, ky është qëllimi in kësaj amnistie. Po ta shohim qëllimin e kësaj amnistie, thuhet “Arritja e qëllimit të dënimit” dhe nuk thuhet “Arritja e qëllimit për hetimin dhe ndjekjen penale”, nuk kemi pse të mbahemi peng tek ai neni për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale, sepse mund të mos e kishim futur fare në tekstin e amnistisë. Madje, nëse doni ta dini qëndrimin tim, unë, si ministër, kam qenë për amnisti vetëm për të dënuarit, fare për ndjekjen penale, as për kundërvajtjet e as për kategoritë e tjera përfituese.

Ta lëmë drejtësinë e re të ushtrojë në mënyrë të pavarur në funksionet e veta. Ka vepër penale, ka fajësi apo pafajësi, për një që është në hetim dhe gjykim, le të shprehet drejtësia, pastaj le të vijë akti i mëshirës në Parlament.

Megjithatë, kolegët dhe sugjerimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, por edhe kolegët e sistemit të drejtësisë, që menaxhojnë sot sistemin e drejtësisë, e kanë parë të arsyeshme që pse jo, edhe për shkak të eliminimit të *backlog*-ut të disa dosjeve të lehta, që shkojnë në duart e



prokurorisë dhe të gjykatës, të kemi këtë amnisti gjerë. Pra, t'i japim një frymëmarrje edhe sistemit të drejtësisë. Ky ka qenë qëllimi që e kemi përfshirë edhe ndjekjen penale.

Do t'u lutesha kolegëve deputetë, jo vetëm të mazhorancës, por edhe të opozitës, të cilët janë të lirë shprehen në mbledhjen e komisionit, sepse janë anëtarë të Komisionit të Ligjeve, të mos e pengojnë ligjin "Për dhënien e amnistisë".

Një nga qëllimet është edhe mbipopullimi, por jo qëllim në vetvete, qëllim në vetvete është t'i japësh mundësi të shkojë në shtëpi një gruaje, e cila është dënuar, ka vuajtur mbi 2/3-at e dënimit dhe i kanë ngelur edhe 5-6 muaj për të shkuar në shtëpi; t'i japësh mundësinë një të mituri të shkojë në shtëpi dhe të ndjekë programet e risocializimit, të integritit e të gjitha me radhë; t'i japësh mundësi një të dënuari 76-vjeçar të shkojë në shtëpi ose të përfitojnë 1 vit zbritje dënimi. Ky është qëllimi i kësaj amnistie. Të gjitha të tjerat pastaj për aludime për amnisti me emra të veçantë, për amnisti që shkon në allishverishe, ai që i mendon këto gjëra, do të thotë që i ka bërë vetë ato. Nuk dua ta çoj në mend këtë gjë, por akt mëshire do të thotë të jesh fisnik, ta përdorësh votën për atë qëllim fisnik për të cilin ta kanë dhënë zgjedhësit. Është akt i Parlamentit. Asnjëherë nuk është diskutuar një amnisti kaq sa është diskutuar ky projektligj. Asnjëherë! Unë jam deputet prej 3 mandatesh së bashku me shumë kolegë të vjetër të kësaj mazhorancë, madje, shtysat kryesore për të pasur një ligj amnistie i kemi pasur nga kolegët e opozitës edhe në mandatet e kaluara. Tani shfrytëzohet varianti i 84 votave.

Më falni, se u zgjata pak! Por si mund të bëhet një amnisti, kur ai thotë: "Të amnistohen personat që kanë marrë pjesë në tubime nga viti 2018 deri në vitin 2020."? Po këta që kanë protestuar nga viti 2020 deri në vitin 2024 dhe do të protestojnë edhe sot, pse nuk kanë të drejtë që për të njëjtën vepër të përfitojnë nga amnistia, apo kështu ma do "oborri" im? Jo! Që këtu ne si Ministri e Drejtësisë do të duhej të kishim mbajtur qëndrim. Ajo nuk quhet amnisti, quhet falje. Nëse kanë një problem me personat e dënuar nga drejtësia për pjesëmarrje në tubime dhe që janë dënuar me vendim të formës së prerë nga vitit 2018 deri në vitin 2020, le t'i propozojnë Presidentit të Republikës t'i falë Presidenti i Republikës. Amnistia është akt ligjor i sovranit, është i Parlamentit. Jo po tani të ngrihet edhe pjesa tjetër e opozitës dhe të thotë: "Dua edhe unë të amnistohen ata që morën pjesë në protesta nga vitit 2020 deri në vitin 2022", sepse dua të amnistohen edhe ata që shkuan te Selia e Partisë Demokratike njëra palë kundër palës tjetër. Ne e kemi bërë të gjerë, nuk ka afate kohore. Kush përfiton nga amnistia, përfiton. Pra, të gjithë përfitojnë njëllë, në mënyrë të barabartë. Të tjerat pastaj janë pazare dhe allishverishe.

Të nderuar kolegë deputetë, unë sot jam në dispozicionin tuaj për ta diskutuar nen për nen këtë projektligj, i cili, pse jo, ka nevojë ndoshta edhe për riformulime teknike, të karakterit të teknikës legislative, në nene të caktuara, që kërkojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e secilit prej kolegëve në Komisionin e Ligjeve, por jo të mbetemi peng i një vote të cilësuar, një dëshirë apo një vullneti. Detyra jonë si mazhorancë është ta çojmë projektligjin në seancë plenare, pastaj atje, nëse duan të bëjnë politikë dhe të bien ndesh me interesat e votuesve (se edhe ata përfaqësojnë një pjesë të votuesve), barra le t'u mbetet atyre, jo neve. Ne do të duhet t'i shkojmë deri në fund detyrës sonë si ligjvënës.

Shumë faleminderit, por i kisha të nevojshme këto shpjegime!

**Klotilda Bushka** – Shumë faleminderit, Ministër!

Bëtë shumë mirë.

Zoti Koçi.

Zoti Koçi, ndizeni audion!

Teknika!

**Petro Koçi** – Shumë faleminderit!

Edhe unë doja të flisja para zotit Majko lidhur me procedimin e punimeve të këtij komisioni. U bënë tashmë 2 orë që po diskutojmë dhe një pjesë e diskutimeve ishin vërtet thelbësore, me shumë brumë, në raport me përmbajtjen e amnistisë. Unë kam qenë që në fillim për një amnisti më të guximshme, duke përfshirë më shumë njerëz të cilët amnistohen, por natyrisht që nuk falen, pra gabimet nuk falen, por amnistohen si një shenjë që i jep institucioni i Parlamentit dhe populli, në raport me një kategori njerëzish që kanë gabuar, një pjesë e tyre shumë rëndë. Mendoj që nuk është nevojshme të kemi më shumë kohë në dispozicion. Besoj se kanë mjaftuar 3 muaj e ca. Sigurisht që kjo çështje është edhe vullnet politik. Mendoj që Partia Demokratike, që përfaqëson zoti Alibeaj, e ka kohën në dispozicion deri në seancën e ditës së enjte, për të reflektuar për aspekte të caktuara të amendamenteve që janë paraqitur. Ne nuk po e akuzojmë zotin Alibeaj se po interesohet për një fashë të dënuarish që lidhen me protestat e partisë së tyre. Pra, nuk po e quajmë konflikt interesi. Prandaj nuk ka vend këtu për asnjë lloj akuze, sipas së cilave amendamentet e propozuara nga deputetët nisen nga emra apo nga individë të caktuar që mund të jenë sot nëpër burgje apo në procese hetimore. Dhe ky nuk është një mëkat, në fund të fundit, mëkat është kur ti nisesh nga numra dhe thjesht nga emra dhe jo nga kategori të caktuara të dënuarish apo të qenit nën hetim. Prandaj le të vijojmë tani, të votojmë, sepse ne kemi programuar

aktivitete të tjera sot në cilësinë e parlamentarit. Nuk mund ta shtyjme as pas një ore as pas dy orësh. Kemi punë të tjera, sepse aktivitetet e deputetëve janë gjithëpërfshirëse.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Bashkohem me kolegët!

Atëherë, në kuadër të frymës së bashkëpunimit, duke qenë se bëhet fjalë për një akt shumë të rëndësishëm në shërbim të interesit të qytetarëve, u përpoqa të gjej një lloj bashkëpunimi për ta shtyrë mbledhjen disa orë. Duke qenë se kjo nuk pranohet, pra kërkohet të merret kohë, ndërkohë që ne të gjithë e dimë sa është punuar në 10-ditëshin e fundit, që nga momenti kur është bërë prezantimi i ligjit “Për amnistinë” në komision dhe deri më sot, duke marrë në konsideratë të gjitha amendamentet e ardhura nga kolegët, sepse nuk ka amendament vetëm një koleg i këtij komisioni, por janë disa, dhe janë të përfshira në tabelë (nuk e di pse vetëm një anëtar i komisionit nuk e ka tabelën, kur të tjerët e kanë marrë dhe kanë pasur mundësi të konsultohen me të), thënë këtë, duke qenë se pjesa më e madhe e kolegëve sugjerojnë të vijojmë, atëherë, kolegë, vijojmë. Ju lutem, të bëhemi gati për diskutimin nen për nen! Dilni me kamera!

Për nenin 2 është po i njëjti sugjerim i relatorit.

Po, zoti Ndreca.

**Plarent Ndreca** - Ishte ajo çfarë unë relatova në lidhje me datën e efekteve të amnistisë, që ndryshon nga data 30.11.2023 dhe shkon në 31.01.2024. Ndërkohë, në mos gaboj, zonja Felaj bëri një propozim për pikën 2.

**Klotilda Bushka** - Për përkufizimin.

**Plarent Ndreca** - Po, për të cilin bie dakord në parim, pasi do të ishte mirë që përkufizimi t’i përshtatej përkufizimit që ka Kodi i Procedurës Penale. Do të doja të dija edhe mendimin e ministrit të Drejtësisë për këtë gjë.

**Ulsi Manja** - Zoti Ndreca, ne i kemi referuar përkufizimit që ka Kodi i Procedurës Penale për personat që i shmangen drejtësisë. Po t’i referohemi nenit 247, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale, ky është edhe përkufizimi që është draftuar në tekstin e amnistisë. Në amnistinë e vitit 2020 ka pasur një përkufizim tjetër se cilët janë personat që i shmangen drejtësisë, por kjo na pati krijuar probleme në zbatim. Pse? Sepse thotë: “Person që i është shmangur drejtësisë është shtetasi, i cili i është shmangur ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë deri në datën kaq”. Për sa kohë ne kemi vendosur si datë të marrjes së vendimit të formës së prerë datën 31.04.2024, një person që i shmanget drejtësisë, sigurisht nuk ka arsye t’ia mohojë kush të drejtën që të shkojë dhe

të dorëzohet në organet kompetente. Pra, 2020-ta e lidhte me një datë, pra kush dorëzohet deri më datën 31.12.2019, përfiton nga amnistia. Jo! Ajo, në fakt, lidhet me hyrjen në fuqi të ligjit “Për amnistinë”. Vendimi i formës së prerë është një datë që ne e fiksuam, ndërsa përfitimi nga efektet e amnistisë lidhet pa diskutim me hyrjen në fuqi të ligjit “Për amnistinë”. Prandaj ne i kemi ndenjur strikt përkufizimit që jep Kodi i Procedurës Penale. Pastaj, a i shmanget me vullnet drejtësisë?! Po, sigurisht që me vullnet i shmangen drejtësisë ata... *(nuk kuptohet)*. Por këtë përkufizim ka Kodi. Unë tani po e konsultoja arsyen pse kemi mbajtur këtë qëndrim dhe këtë përkufizim. Pra, kemi mbajtur këtë qëndrim, sepse e ka Kodi i Procedurës Penale.

**Klotilda Bushka** - Në rregull, do t’i qëndrojmë përkufizimit siç është, vetëm me ndryshimin e nenit 2 për afatin, sepse me të drejtë ministri tha: “Përkufizimi është sipas Kodit të Procedurës Penale”. Nuk na krijon asnjë problem.

**Ulsi Manja** - E nderuar kryetare,

Nuk na krijon asnjë problem në zbatim ky përkufizim, sepse lidhet me personat që i shmangen drejtësisë. Nuk lidhet as me marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor penal, as me hyrjen në fuqi të amnistisë. Këto janë të përcaktuara strikt në tekstin e ligjit. Kujt i ka marrë vendimi formën e prerë deri në datën 31.01.2024 dhe që përfiton sipas këtij teksti, është kategori përfituese. Kujt i merr vendimi formën e prerë pas datës 31 janar 2024, nuk përfiton, edhe pse vepra penale për të cilën dënohet përfiton. Nuk kemi probleme me nenin 2.

**Klotilda Bushka** – Dakord!

Mirë, edhe zonja Felaj sugjerim e kishte, nuk e bëri në formën e një amendamenti. Edhe unë bie dakord që, nëse jemi përpara rastit që kemi marrë përkufizimin e Kodit të Procedurës Penale, mendoj se është e drejtë, dhe nuk ka pse sjell problematikë në zbatimin në praktikë.

**Ulsi Manja** - Më lejoni që për korrektësi ta lexoj: “Person që i shmanget drejtësisë, konsiderohet personi që, megjithëse ka dijani, i shmanget me vullnet zbatimit të masave të sigurimit ose dënimit me burgim”. Këtë thotë Kodi.

**Klotilda Bushka** - Mirë, nëse jemi dakord, vazhdojmë me nenin 2, me sugjerimin sipas tabelës. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kolegë, ndizini kamerat! Kush është kundër, të shkruajë në grup.

Neni 3.

Relatori? Këtu është: amendamenti i zotit Alibeaj, amendament i zotit Nallbati, amendamenti i zoti Xhaferraj, amendament i zotit Salianji. Në versionin e paraqitur nga relatori është bërë riformulimi i disa pikave. Sipas nenit 76 të Rregullores, pika 3, i pari do të votohet propozimi i relatorit. Nëse ky propozim merret parasysh, votohet. Atëherë nuk hidhen në votim amendamentet e tjera.

Vijojmë me relatorin për një shpjegim të propozimit.

Zoti Ndreca, hapeni audion!

**Plarent Ndreca** - Te neni 3, propozimi është që te pika 1, në germën “a” togfjalëshi “deri në 3 vjet” të zëvendësohet me togfjalëshin “deri në 4 vjet”. Në germën “b” togfjalëshi “deri në 4 vjet” të zëvendësohet me togfjalëshin “deri në 5 vjet”. Pra, bëhet fjalë për ndryshimin nga 3 vjet në 4 vjet për meshkujt dhe nga 4 vjet në 5 vjet për gratë (për ata që janë të dënuar). Në germën “c” togfjalëshi “deri në 3 vjet” të zëvendësohet me togfjalëshin “deri në 4 vjet”. Në germën “ç” togfjalëshi “deri në 4 vjet” të zëvendësohet me togfjalëshin “deri në 5 vjet”. Ky është propozimi që ne kemi bërë për ndryshimin e pikës 1 të nenit 3.

**Klotilda Bushka** - Ministria, jeni dakord?

**Ulsi Manja** - Dakord, është amendament i dakordësuar me relatorin. Jemi dakord me propozimin e relatorit.

**Klotilda Bushka** - Në rregull.

Një sekondë, se dy kolegë kanë probleme me audion.

Dakord me nenin 3, sipas sugjerimeve të relatorit.

Kalojmë në votim, sipas nenit 76, pika 3, të Rregullores. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është kundër dhe nuk del dot me video, të shkruajë në grup.

Neni 4.

Zoti Ndreca.

**Plarent Ndreca** - Te neni 4, e nderuar zonja kryetare, janë bërë disa ndryshime dhe saktësime në përputhje edhe me kërkesat e amendimeve që kanë propozuar deputetët e opozitës. Te germa “k” e nenit 4 hiqet vepra penale 238, një ndër ato vepra penale që ishte kërkuar nga zoti Alibeaj (unë e bëra shpjegimin gjatë diskutimit me të), si dhe është shtuar një vepër penale, paragrafi i parë i nenit 263: “Organizimi dhe grumbullimi i manifestimit të paligjshëm me

pjesëmarrjen e personave të armatosur”. Pra, këtu është shtuar një ndalim, sepse bëhet fjalë për organizim dhe grumbullim, manifestim të paligjshëm me persona të armatosur. Ky është dallimi dhe është shtuar te “Ndalimet”. Ky është ndryshimi që kemi propozuar te neni 4, germa “k”.

**Klotilda Bushka** - Ministria, jeni dakord?

**Ulsi Manja** - Jemi dakord me relatorin, madje në logjikën e një propozimi që ka relatori për nenin 6, pika 3, kur të vijmë më vonë, te “Kriteret ndaluese” te germa “k” është shtuar edhe neni 257, germa “a”, që ka të bëjë me refuzimin për deklaram, deklarimin e pasaktë apo fshehjen e pasurisë.

**Klotilda Bushka** – Dakord.

Mirë, kolegë, nëse fjalën nuk e do dikush tjetër, po shikoj nëse janë ngritur duart edhe te grupi i komunikimit.

Kalojmë në votimin e nenit 4, sipas sugjerimeve të relatorit, të dakordësuara edhe me Ministrinë e Drejtësisë. Pro? 15 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

**Vijojmë me nenin 5.**

**Po, zoti Ndreca, një shpjegim të propozimit.**

**Plarent Ndreca** - Te neni 5 “Kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit” ishte ajo që ne përmendëm në fillim të prezantimit. Në pikën 2, germa “c” shfuqizohet: “Personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 75, germa “a”, të Kodit të Procedurës Penale”. Bëhet fjalë për të gjithë ata persona që përfitojnë nga ulja. Ulja duhet të jetë e barabartë, në respekt të parimit të barazisë para ligjit. Për sa kohë personat që janë të dënuar tashmë me një vendim të formës së prerë thjesht përfitojnë një ulje prej një viti e gjysmë dhe një vit nga dënim i mbetur, është gjykuar të ketë një ulje për të gjithë personat, pa bërë përjashtim, pavarësisht se nga cila gjykatë është shqyrtuar çështja. Gjithsesi, mbeten të përjashtuar ata që janë dënuar për krime kundër jetës, personat të cilët janë dënuar për krime në rrethana cilësuese, pra ndaj funksionarëve publikë, policëve dhe marrëdhëniesve familjare. Por vetëm ky ndryshim është propozuar, në mënyrë që të barazohen me kategori të tjera në përfitimin e uljes së dënimit.

**Klotilda Bushka** - Qartë! Pra, është neni 5 “Kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit”. Ministria e Drejtësisë, Ministër, jeni dakord me këtë sugjerim?

**Ulsi Manja** - Jam dakord me sugjerimin, por dua të jem i qartë: neni 5, pika 2, germa “c”, që shfuqizohet, ndjek parimin e barazisë të kategorive përfituese përpara ligjit, që do të thotë se vërtet janë dënuar nga Gjykata e Posaçme, por nga Gjykata e Posaçme, për shkak të lidhjes së subjekteve, ka të dënuar që jo detyrimisht janë zyrtarë të lartë dhe, nëse ne i japim mundësinë të përfitojë zbritje të dënimit një personi të dënuar nga gjykata e juridiksionit të përgjithshëm për vepra të rënda, nuk mund t’ia mohojmë të drejtën e përfitimit “zbritje nga dënimi” kësaj kategorie thjesht dhe vetëm për shkak të kompetencës së gjykatës.

Dua t’ju falënderoj që Komisioni i Ligjeve është kujdesur për ta siguruar këtë barazi të trajtimit të kategorive përfituese përpara ligjit. Ne, sigurisht, jemi propozuesit, unë jam ministri i Drejtësisë dhe jam përfaqësues i ekzekutivit, por sigurisht që Parlamenti e ka këtë diskrecion, e ka këtë pushtet që të kujdeset për të siguruar zbatimin e barabartë dhe të njëjlojtë të ligjit për të gjithë.

Jam plotësisht dakord me sugjerimin. Por bëhet fjalë për zbritje, jo për përfitim të plotë nga amnistia.

**Klotilda Bushka** – Bëhet fjalë për rregullin e përgjithshëm “Kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit”. Jemi të qartë për këtë.

**Ulsi Manja** - Jam dakord.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, Ministër!

Kolegë, kalojmë në votim, sipas sugjerimit të relatorit. Pro? 15 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale”.

Relatori.

**Plarent Ndreca** - “Te kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale”, në pikën 1 bëhen ndryshimet që i përmendëm, që kanë lidhje me datën: nga 31 nëntor, kthehet më 31 janar 2024. Tani jemi në rastin e ndjekjes penale. Ndërkohë te veprat që nuk përjashtohen nga pushimi i ndjekjes penale, në pikën 1, hiqen ato vepra që janë të lidhura me kërkesat, që janë bërë edhe nga amendimet e deputetëve Nallbati dhe Alibeaj dhe hiqen veprat penale 90, “Rrahja” dhe 92 “Plagosje e lehtë nga pakujdesia”; bëhet saktësimi te neni 112 paragrafi i parë, sepse neni 112 ka disa paragrafë, hiqet paragrafi i parë i nenit 236, por jo të gjithë paragrafët, “Kundërshtimi i punonjësve të policisë së rendit”, pra hiqet vetëm paragrafi i parë i tij; neni 238 “Kanosja për shkak të detyrës”, si dhe hiqen paragrafi i parë dhe i tretë i nenit 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm

të funksionarëve publikë”, me sugjerimet që janë bërë nga deputetët Alibeaj dhe Nallbati, ku ne kemi bërë edhe riformulimin përkatës, siç është në tabelën, që të mos e lexoj, por nëse është e nevojshme, e lexoj.

**Klotilda Bushka** – Jo, nuk është e nevojshme ta lexoni, por keni edhe për pikën tre të nenit 6.

**Plarent Ndreca** – Po, por mendova se do të më...

**Klotilda Bushka** – Jo, duhet sepse do të votojmë nenin me gjithë propozimin, kështu që shpjegojini të gjitha në tërësi.

**Plarent Ndreca** – Ndërkohë, te pika 3 e nenit 6 është ndryshimi që folëm. Në propozimin e ardhur nga qeveria ishin të përfshirë të gjithë punonjësit zyrtarë të mesëm, pra që janë deklarues të pasurive dhe detyrimeve financiare të zgjedhur si nëpunës publikë.

Ndërkohë, ne kemi lënë, sigurisht, subjektet e posaçme dhe ata, të cilët janë të akuzuar apo nën hetim nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 75/a, germa “c dhe ç” të Kodit të Procedurës Penale. Kemi lënë, po ashtu, të gjithë zyrtarët, të cilët hetohen për veprat penale, që lidhen me deklarin e pasurisë, por, sigurisht, i kemi përjashtuar këta për vepra penale, që nuk kanë lidhje fare me detyrën apo me deklarin e pasurisë. Pra, nuk ka pasur arsye përse duhet të diskriminohen zyrtarë të mesëm, e theksoj zyrtarë të mesëm, jo zyrtarë të lartë, që të përfitojnë nga amnistia për vepra penale të lehta, deri në dy vjet burgim, vepra të cilat nuk kanë asnjë lidhje me detyrën që ata ushtrojnë apo me deklarin e pasurisë. Ky është ndryshimi që ne kemi bërë te pika 3 e nenit 6 të projektligjit.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Po për propozimin e zonjës Felaj: nëse është rasti për ta diskutuar, sepse besoj se në këtë pikë mund të shihet?

**Plarent Ndreca** – Te propozimi i zonjës Felaj mendoj që ka, le të themi, një moment për t’u parë me kujdes, sepse jemi duke folur për hetimin. Pra, nëse ne bëjmë një ngritje të tavanit për personat e dënuar, flasim për personat që kanë kaluar një filtër gjyqësor, pra janë të dënuar me vendim të formës së prerë dhe janë vlerësuar nga gjykata. Në këtë rast unë mendoj, por më duhet edhe mendimi i ministrit të Drejtësisë, se duhet të kemi kujdes, për shkak se rritja e tavanit te personat nën hetim mund të krijojë probleme, sepse kemi parasysh që kemi të bëjmë me persona që janë akoma nën hetim, pra nuk kanë kaluar një filtër. Janë persona, të cilët ne “ia heqim organit të drejtësisë” nga hetimi, për shkak të rëndësisë së ulët të veprës penale, pra për vepra penale



shumë të lehta, që janë deri në dy vjet. Kështu që, do të doja edhe mendimin e ministrit të Drejtësisë, nëse bie dakord me mua këtu për këtë shqetësim, por, megjithatë, e le në vlerësimin e kolegëve.

**Klotilda Bushka** – Në rregull!

Po, zoti Ministër!

**Ulsi Manja** – Ne e kemi bërë këtë diskutim, por lëvizja e kufirit, pra e marzhit të dënimit për amnistinë nga ndjekja penale, tej kufirit të ndarjes së kundërvajtjeve me krimet, na krijon probleme në zbatim. Pra, ne futemi në terrenin e amnistisë nga ndjekja penale të veprave me rrezikshmëri shoqërore dhe të cilësuarat si krime, sipas Kodit Penal.

Statistika që disponojmë lidhur me nenin 6, i referohem ndarjes, ku kemi: krime dhe kundërvajtje.

Sigurisht, kemi propozuar që të kishim një fashë tjetër për sa i takon amnistisë nga ndjekja penale, por organet e drejtësisë kanë qenë kundër në mënyrë kategorike. Pra, kanë kërkuar të ruhet linja tradicionale e amnistisë nga ndjekja penale, që ka të bëjë me kufirin e ndarjes së kundërvajtjeve me krimet. Ne, në fakt, e kemi tentuar këtë, edhe pse kjo kërkonte një listim nominal të të gjitha veprave që përfitojnë nga ndjekja penale, nëse do të lëviznim kufirin e dënimit nga dy, le të themi, në tre, apo nga dy deri në katër, por organet e drejtësisë, kanë qenë kundër lëvizjes së këtij kufiri, sepse kjo u krijon vështirësi edhe në zbatimin e ligjit të amnistisë. Përpos kësaj prek edhe balancën që kërkon të ruhet në ligje të tilla, shumë të ndjeshme, dhe që interpelojnë punën e organeve të sistemit të drejtësisë. Kjo ka qenë linja dhe qëndrimi ynë.

Lidhur me riformulimin e pikës 3 të nenit 6, që zoti Alibeaj në fillim të kësaj seance tha se kjo është zbutje qëndrimi, në fakt, ne kemi marrë të njëjtin përkufizim që kanë pasur të gjitha amnistitë lidhur me subjektet e deklaramit të pasurisë, këtu janë shtuar vetëm subjektet që gjykohen nga Gjykata e Posaçme. Nuk është zbutje qëndrimi, sepse, nëse ne i japim mundësinë të përfitojë nga ndjekja penale një zyrtari të mesëm, që aktualisht është nën hetim dhe gjykim nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm, këtë mundësi për këtë vepër duhet t'ia japim edhe një zyrtari të mesëm, apo një qytetari të zakonshëm, që për shkak të lidhjes së procedimit aktualisht është nën hetim dhe gjykim nga Gjykata e Posaçme. Ndërkohë, kategoria e zyrtarëve të lartë, sipas nenit 75/a, që përmbledhen në gjerat “c” dhe “ç”, është e përjashtuar si kategori përfituese. Për më tepër si siguri ligjore, që kjo kategori të mos përfitojë nga ky riformulim, ne kemi futur në pikën 1, si kategori përjashtuese, nenin 257/a, e kemi futur edhe te kriteret ndaluese të nenit 4, por e kemi

futur si kriter përjashtues edhe te pika 1 e nenit 6. Kështu që, riformulimi i propozuar nga relatori siguron parimin e përgjithshëm të barazisë përpara ligjit dhe të përfitimit të të gjitha kategorive.

Po ju jap një shembull shumë të thjeshtë: një zyrtar i mesëm aktualisht është nën hetim, apo gjykohet në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm, paralelizmi nuk është ndoshta i duhuri për drejtim mjete pa patentë. Tani, një zyrtar i mesëm, që aktualisht është nën hetim në Prokurorinë e Posaçme për shkak të lidhjes së procedimit, por ka edhe një akuzë të kësaj natyre, jo akuza që kanë të bëjnë me korrupsion apo shpërdorim detyre, nuk përfiton si kategori. Megjithatë, riformulimi është i saktë dhe i duhur.

A duhet të rrimë ne se ka qenë tradita që tek të gjitha amnistitë ka qenë i njëjti formulim? Ne si propozues, si nismëtarë, u dakordësuam me këtë traditë dhe formulim të zakonshëm, por kjo nuk do të thotë që për shkak të traditës ne të ngelemi dhe të mos kemi formulime të sakta dhe të qarta ligjore kur kemi të bëjmë me një ligj amnistie. Kështu që, në këtë kuptim jemi dakord me propozimin e relatorit.

**Klotilda Bushka** –Fjalën e ka zonja Felaj.

**Ermonela Felaj** – Kam vetëm një koment për këtë pikë, për të cilën do të doja të ndërhyja. Unë nuk do të isha dakord me idenë që sa herë bëjmë një amnisti, gjithmonë e më shumë t'i vendosim kushte ndaluese dhënies së amnistisë, sepse, nëse ne i shtojmë kushte ndaluese, parimisht do të humbasim kuptimin e amnistisë. Çfarë vlere ka një amnisti, ku më shumë i vendos ndalime sesa përjashtime?

Më tërhoqi vëmendje diskutimi i nenit 257/a dhe në përgjithësi ligji i amnistisë. Amnistia duhet të lidhet me veprën penale, me dënimin, jo me kohën e ndodhjes së ngjarjes, për shembull, siç propozohet. Nuk është lidhur ndonjëherë dhe nuk ka sens ta lidhësh, sepse nuk e lejon ligji ta lidhësh me kohën e ndodhjes së ngjarjes dhe as me subjektin.

Vepra penale e nenit 257/a, ka një subjekt të posaçëm në kuptimin e përgjithshëm, për të gjithë ata që detyrohen të deklarojnë para ILDKPI-së, por nuk ka një subjekt të posaçëm në kuptimin e veçantë, pra që të ketë një ndarje kaq do të jetë dënimi për ata që kryejnë këtë veprë, por që janë zyrtarë të ulët, kaq do të jetë dënimi për ata që janë të mesëm dhe kaq për zyrtarët e lartë. Kështu që, unë them që në diskutimin e amnistisë dhe ligjeve të tjera, duhet të na ndihmojnë më shumë skrupujt ligjorë, jo skrupujt politikë, se po të nisemi me skrupuj politikë, unë nuk e di se në çfarë konsensusi do të mbërrinim dhe çfarë amnistie do të bënim.

Pra, këtë e kam një koment për të gjithë kolegët, që nuk duhet të shkojmë në këtë drejtimi: mbyll, rrit listën e neneve ndaluese nga Kodi Penal, sepse pastaj humbet i gjithë kuptimi përfshirjes sonë në një akt të tillë, që në thelb konsiderohet akt mëshire. Nuk besoj se po i trajtojmë siç duhet të gjitha subjektet që vendosen para ligjit, po përzgjedhim ne t'i trajtojmë, ndërkohë që ligji ka zgjedhur një tjetër trajtim të tyre për veprat që kryejnë.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zonja Felaj, a keni propozim për këtë?

**Ermonela Felaj** – Unë e bëra propozimin tim në raport me atë çfarë ishte propozuar më herët për faljen e një mase të konsiderueshme nga masa totale e dënimit, katër dhe pesë vjet, që nuk më duken pak, sepse besoj se duke e mbledhur edhe me pjesën e vuajtur të dënimit bëhet fjalë për dënime jo të vogla dhe për vepra jo me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Kështu që, u nisa nga kjo pjesë, si dhe duke parë disa nene të Kodit Penal. Por, sigurisht, propozimi im për këtë pjesë nuk është kusht, në kuptimin që po nuk u votua kjo, nuk do të votoj propozimin e kolegëve. Unë do ta votoj qëndrimin e kolegëve, por e kisha merak ta bëja këtë tërheqje vëmendjeje, sepse ne po kujdesemi më shumë për të thënë që, meqenëse ne jemi mazhoranca qeverisëse, çfarë janë zyrtarë të lartë, të cilët po përballen sot me drejtësinë ne do t'i trajtojmë ndryshe. Tani, këtu unë nuk i jap dot kuptim, sipas ligjit, sepse ligji i ka trajtuar njësoj, ashtu sikundër e shpjegova, nuk i ka trajtuar në mënyrë të diferencuar, sa i takon dënimit e kam fjalën dhe veprës së njëjtë të kryer, nuk po flas për juridiksionin dhe kompetencën.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Felaj!

Neni 6 “Kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale”, riformulohet:

“Përjashtimi nga ndjekja penale për çështjet penale në hetim”, për ato vepra, të cilat listohen në riformulim, saktësohet që subjektet deklarues (dhe unë këtu jam dakord me zonjën Felaj) që janë zyrtarë të mesëm apo të vegjël, sigurisht, nëse janë për çështje që lidhen me detyrën kuptohet që nuk kanë amnisti, por, nëse ata janë subjekt i një procedimi penal për çështje të tjera, fjala bie një aksident, është i saktë formulimi. Por, nga ana tjetër, duke i marrë subjektet këtu, nisur nga edhe çfarë është bërë në amnistitë e tjera, ndoshta për të ardhmen duhen parë.

Meqenëse ne këtu jemi proceduralisht te formulimi i relatorit, i cili e ka çuar në këtë frymë të asaj që ne themi, por jo në formulim, sepse, në qoftë se do të ecim me logjikën e zonjës Felaj dhe të asaj që unë bie dakord, nuk duhet të ishte fare, në fakt, kjo kategori e shkruar këtu, nuk do të merreshim me veprën.

Gjithsesi, duke qenë se ka një dakordësi midis relatorit dhe Ministrisë së Drejtësisë, nëse jemi dakord, kalojmë në miratim, sipas propozimit të relatorit?

Zoti Ministër, jemi dakord? Dakord.

Pro? 15. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 “E drejta civile në procesin penal”, sipas versionit të qeverisë. Nuk ka propozim.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është kundër le të shënojë, nëse nuk e hap dot kamerën.

Neni 8 “Hyrja në fuqi”, sipas versionit që ka sjellë Këshilli i Ministrave.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vijojmë me miratimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për amnistinë”

Pro? 15.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Kolegë kemi miratuar në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për amnistinë”. Versioni që do t’i shkojë seancës plenare do të jetë një version integral, teksti do të jetë i dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë, me relatorin dhe me të gjitha organet që u konsultua në lidhje me këto amendamente.

Në bazë të nenit 76/3 të Rregullores së Kuvendit, janë votuar si amendamente që do t jenë pjesë e tekstit integral, propozimet e relatorit, që marrin në konsideratë dhe amendamentet e deputetëve të tjerë. Prandaj, ne do të ecim me një version integral në seancën plenare.

Në thelb ndryshimet që ne miratuam, si komision, marrin parasysh disa nga komentet e deputetëve të opozitës apo të kolegëve të mazhorancës, të paraqitura me shkrim, disa nga sugjerimet e Komisionit të Sigurisë, të cilat janë konsultuar me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë për hapësirat dhe për të marrë në konsideratë propozimet, si dhe kanë për qëllim përmirësimin nga ne, si Komision i Ligjeve, në përputhje me parimet e amnistisë penale.

Në këtë kuadër, të merren në konsideratë edhe në hartimin e raportit për seancën plenare, që efekti i amnistisë do të jetë nga data 31.01.2024 dhe të gjitha ndryshimet që u miratuan në komision. Teksti integral, i zbardhur, të bëhet gati sot së bashku me raportin dhe t’u shpërndahet

të gjithë kolegëve të komisionit dhe të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe të shpallet në faqen e internetit të Kuvendit.

Kolegë, shumë faleminderit!

Zoti Ministër, faleminderit!

Mendoj se kemi bërë një punë të mirë. Uroj që ky ligj, kaq i rëndësishëm dhe kaq i shumëpritur, të marrë edhe votën e deputetëve në seancë plenare!

Ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretar**  
**Klevis Xhoxhi**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Koordinatore e komisionit**  
**Vijola Sinaj**